



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR

Nr. 4049/3 Prot.

Tiranë, më 31.7.2024

Lënda: Për ndjekje dhe kompetencë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ✓  
Rruga "Naim Frashëri", Nr.37  
Tiranë

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
Rruga "Aleksandër Moisiu", përballë IKV-së  
Tiranë

Në përgjigje të shkresës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar me nr. 533 prot., datë 21.06.2024, me lëndë: "Për miratimin e programeve mësimore për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të orientuar me drejtim artistik" regjistruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), me nr. 4049 prot., datë 25.6.2024, bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 367, prot., datë 18.07.2024, "Për miratimin e programeve mësimore të kurrikulës artistike, të klasave të caktuara me drejtim artistik në arsimin bazë dhe programeve mësimore të arsimit të mesëm të lartë të orientuar me drejtim artistik".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Gola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

## **KURRIKULA ARTISTIKE**

**Programet e degës: MUZIKË – AMU**

**Specialitet: Violina, Violë, Violonçel, Piano, Flaut, Oboe, Klarinetë, Fagot, Saxophon,  
Korno, Trombon, Kontrabas, Kitarë, Fizarmonikë, Perkusion.**

**Për klasat: I-IX**

**Tiranë, 2024**

## Përmbledhje

1	HYRJE.....	3
2	QËLLIMI I DEGËS MUZIKË.....	3
3	TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR SPECIALITETET.....	4
-	3.1 TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR SPECIALITETET SEKONDARE.....	5
-	3.2 TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT TEORIKE ARTISTIKE.....	5
-	3.3 TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT PRAKTIKE ARTISTIKE.....	5
4	UDHËZIME METODIKE.....	6
-	4.1 UDHËZIME METODIKE TË PËRGJITHSHME (specialitetet).....	6
-	4.2 PËR INSTRUMENTISTËT.....	6
-	4.3 UDHËZIME METODIKE PËR LËNDËT TEORIKE DHE TEORIKE – PRAKTIKE.....	8
5	UDHËZIME PËR VLERËSIMIN.....	9
6	PROGRAMET LËNDORE.....	11

## PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

### 1 HYRJE

Muzika, së bashku me mësimin e llojeve të tjera të artit në shkollat artistike është bërë objekt i një trajtimi të specializuar e profesional, e cila kërkon një vëmendje të posaçme edhe ndaj dokumentacionit bazë dhe përdorimit të tij në procesin konkret të edukimit artistik. Kjo e bën të domosdoshëm plotësimin e dokumenteve kryesore sikurse është edhe kurrikula artistike për trajtimin e lëndëve, ku do të përfshiheshin detyrimisht udhëzimet e nevojshme që nga përmbajtja muzikore, metodologjitë dhe vlerësimi i nxënësve në çdo nivel dhe cikël.

Në një kuadër të tillë, hartimi i kurrikulës artistike për mësuesit e degës muzikë është menduar të jetë një udhërrëfyes i përgjithshëm për të orientuar lëndët teorike, teorike praktike dhe specialitete për çdo klasë, nivel dhe cikël shkollor për të bërë të mundur unifikimin dhe orientimin e të gjitha përmbajtjeve mësimore përmes tematikave, metodologjive dhe vlerësimit në momente të veçanta të procesit mësimor.

Kështu, specialitetet që zhvillohen do të tregojnë në mënyrë sa më konkrete e të qartë lidhjen mes pjesëve të programuara të kurrikulës; mundësinë që ato të trajtohen në mënyrë organike e si pjesë të njëra tjetrës dhe bashkëveprimin e pashmangshëm të proceseve të krijimtarisë, interpretimit muzikor dhe përjetimit emocional të artit muzikor.

### 2 QËLLIMI I DEGËS MUZIKË

Qëllimi kryesor i arsimit në këtë degë është zhvillimi dhe formimi muzikor dhe artistik i nxënësve për t'u perfeksionuar në veprimtari të ndryshme që lidhen me muzikën, si dhe krijimi i një personaliteti për të jetuar dhe për t'u përballuar me sfidat e ndryshme. Për të realizuar këtë, shkollat artistike, dega muzikë u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi;
- mundësi për të zhvilluar kompetencat profesionale të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të

- mundësi për të lehtësuar përparimin drejt arsimimit të mëtjshëm dhe drejt punësimit;
- mundësi mbështetje për t'u njohur me zhvillimet artistike bashkëkohore;
- mundësi mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, përqendrimit dhe punës artistike;
- mundësi mbështetje për t'u zhvilluar dhe për t'u formuar artistikisht duke i shërbyer vetes dhe komunitetit ku jetojnë, përmes pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme artistike;
- mundësi mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës artistike të punës individuale dhe në grup.

### **3 TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR SPECIALITETET**

- Viola
- Kontrabas
- Flaut
- Oboe
- Klarinetë
- Fagot
- Saxophon
- Korno
- Trombë
- Trombon
- V/cello
- Piano
- Violinë

- Kitarë
- Fizarmonikë
- Perkusion
- Harpë
- Bastuba

### **3.1 TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR SPECIALITETET SEKONDARE**

- Instrument sekondar për pianistët - Harpë
- Instrument Sekondar – Piano
- Instrument sekondar me zgjedhje

### **3.2 TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT TEORIKE ARTISTIKE**

- Solfezhi

### **3.3 TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT PRAKTIKE ARTISTIKE**

- Edukim koral
- Edukim orkestral

## 4 UDHËZIME METODIKE

### 4.1 UDHËZIME METODIKE TË PËRGJITHSHME (specialitetet)

Një mësues do të ketë sukses në punën e tij nëse e do shumë profesionin, ka një vesh muzikor shumë të mirë, durim, dhe implementim teknikash i të qenurit një mësues profesionist.

- Inkurajon e diskuton me durim e pasion me nxënësit për të arritur rezultatet e pritshme.
- Punon sistematikisht dhe i drejton në rrugën e saktë të studimit.
- Mësuesi duhet të përqendrohet në identifikimin e nivelit të nxënësit , aftësive të tyre , duke përdorur metodat e vlerësimit e kështu përcakton rrugën e punës me gjithsecilin.
- Përfshin një repertor të pasur e të përshtatshëm për gjithsecilin në stil e periudha të ndryshme.
- Inkurajon nxënësit në përfshirjen e tyre në aktivitete koncertale.
- Aplikon teknologjinë duke përdorur burime online dhe mjete dixhitale për të shtuar një dimension të ri orës së mësimit.
- Qëllimi kryesor i udhëzimeve metodologjike është të krijojë një mjedis mësues- nxënës aq dinamik dhe inkurajues. Kjo përfshin një kombinim të aftësive teknike, emocionale dhe analitike që do të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë me dashuri e pasion të qëndrueshëm artin e të kënduarit.

### 4.2 PËR INSTRUMENTISTËT

Për të arritur një nivel sa më të mirë të lojës në instrument, nxënësi duhet edukuar të studiojë në mënyrë sa më sistematike. Në këtë proces, puna e mësuesit duhet të jetë e vazhdueshme, e thelluar dhe e lidhur ngushtë me vëzhgimin psikologjik e emocional të nxënësit, që nga hapat e para të formimit, deri në plotësimin e mjaftueshëm të tij. Për të pasur rezultate sa më të mira, trajtimi psikoemocional duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit dhe të synojë, në radhë të parë, një administrim sa më të mirë të orës së mësimit. Përshkrimi i tematikave në të gjithë instrumentet muzikor shihet

si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të “formimit artistik të nxënësit”. Realizimi i repertorit është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e lojës në instrument. Programi përmban kompleksitet i cili përbehet nga elemente si:

- Funksionimi fizik
- Ndjeshmëria ritmike
- Ndjeshmëria muzikore
- Aftësitë emocionale
- Temperamenti
- Kujtesa muzikore
- Vullneti dhe karakteri
- Aftësi performuese në skenë

Zbërthimi i këtyre kompleksiteteve krijon kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë dhe vlerat në funksion të kompetencave artistike. Po ashtu, ndërthurja e kërkesave teknike të lojës në instrument me kërkesat artistike të veprave të veçanta, do t’i jepte orës së mësimit më shumë frymëmarrje dhe do ta bënte atë më të pëlqyeshme për nxënësin.

Në lidhje me zbatimin praktik të programit artistik, është i nevojshëm ndërgjegjësimi i nxënësit me kuptimin e tij, rëndësinë që ka secila pjesë në formimin sistematik të nxënësit dhe mundësitë që krijojnë ato për avancimin e tij gradual. Kështu, ushtrimet, etydet dhe pjesët e tjera artistike të programit duhet t’u përgjigjen grupmoshave të ndryshme dhe, nga ana tjetër, t’u japin mundësi individëve më të përparuar të ecin lirshëm e pa sforcime.

Përzgjedhja e veprave duhet bërë me kujdes përpos përgatitjes, talentit dhe ecurisë së secilit nxënës. Duhet këmbëngulur në kultivimin e shijeve të sakta të lojës. Pas studimit të ngadaltë, nxënësi duhet nxitur për të luajtur (manovruar) më shpejt me materialet, por gjithnjë pa e tepruar dhe nën kontrollin e mësuesit, me perspektivën drejt vetëkontrollit.



Nxënësi duhet të ndërgjegjësohet e të perceptojë me siguri të lartë atë çfarë ai prodhon, si dhe të nxitet për të performuar në skenë.

Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, edhe kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt e, së fundi, trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partit . Sipas kësaj dinamike, edhe kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen.

Për arritjen e një niveli të mirë të nxënësit, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të tij (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).

Mësuesi duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale, në mënyrë që të mos jetë thjesht një kopje e mësuesit (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike) por të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur.

#### **4.3 UDHËZIME METODIKE PËR LËNDËT TEORIKE DHE TEORIKE – PRAKTIKE**

Udhëzimet dhe metodat didaktike janë të domosdoshme të ndërthurën me njëra tjetrën gjatë gjithë orës së mësimit, në përputhje me nivelin e dijeve, objektivat e lëndës, por edhe në funksion të risive të reja që mund të përdoren nga mësime dhënësit dhe nxënësit. Disa metoda përmendim:

- Metoda e shpjegimit;
- Metoda e bisedës;
- Metoda e leximit dhe punës me tekst;
- Metoda e punës me kompjuter për veprat kryesore;
- Metoda e të mësuarit dhe të nxënimit ndërveprues;

- Metoda e diskutimit të lirë dhe debatit.

Një moment tjetër është dëgjimi i literaturës muzikore e cila nuk duhet të mungojë në klasë. Dëgjimi i literaturës muzikore zhvillohet duke veçuar pjesët më të vështira teknike dhe duke i analizuar me mënyra dhe forma të ndryshme studimi .

Çdo mësimdhënës është i lirë të përzgjedhë nga metoda të ndryshme, për ta bërë sa më efektive procesin mësimor në klasë.

## 5 UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi në shkollat artistike dega “Muzikë”, është procesi gjatë të cilit mbledhen të dhëna dhe gjykohet, mbi bazë të kriterëve të caktuar, për të matur dhe për të vlerësuar të gjitha aspektet e procesit *të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve* ndaj muzikës por edhe *interpretimit/performancës artistik*. Qëllimi kryesor i vlerësimit në degën “Muzikë” është:

- Të sigurojë informacion të plotë për arritjet e nxënësit në formimin teorik muzikor, teoriko – praktik dhe të specialitetit.
- Të sigurojë informacion për shkallën e realizimit të rezultateve të pritshme të të mësuarit në kulturën artistike.
- Të motivojë nxënësit për arritje më të larta.

Për të realizuar qëllimin e tij vlerësimi duhet të jetë: *i drejtë/i paanshëm/i ndershëm, i plotë/objektPaanshmëria/ndershmëria* e vlerësimit garantohej nga përdorimi i kriterëve të unifikuar për vlerësimin e nxënësit. Është detyrë e shkollës dhe e mësuesit që të garantojë kushtet e përshtatshme dhe motivuese të të mësuarit, duke e trajtuar procesin e vlerësimit si pjesë e procesit të të mësuarit dhe të mësimdhënies. Për këtë arsye, mësuesi duhet të planifikojë dhe të ndërtojë situata të mësuarit që u japin mundësi nxënësve të realizojnë njohuritë e kurrikulës artistike në fushën e formimit muzikor - artistik si dhe t’u japë atyre mundësinë për të demonstruar shkallën e arritjes së këtyre njohurive dhe aftësive.

Vlerësimi në muzikë shpreh kriterë të njësuar artistike për:

- vlerësimin e njohurive teoriko-muzikore,
- krijimin e shprehive teknike,

- zotërimin e elementeve teknike sipas specialiteteve përkatëse,
- zhvillimin e potencialit interpretativ muzikor - artistik.

Mësuesi, në përputhje me parimet themelore dhe kriteret e vlerësimit, siguron kriteret e vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me njohuritë apo performancën muzikore të nxënësve. Vlerësimi do të zhvillohet si më poshtë:

**Nga klasa 1-12 programi mësimor do të realizohet në dy periudha Shtator - Janar dhe Shkurt - Qershor.**

- Vlerësimi kryhet me shprehje dhe notë nga mësuesi i specialitetit, si dhe përmes kontrolleve teknike dhe saxhove.
- Vlerësimi vazhduar me shprehje nga mësuesi i specialitetit klasa 1-3.
- Vlerësimi i vazhduar me notë nga mësuesi i specialitetit klasa 4-12.
- Çdo specialitet duhet të realizojë përgjatë çdo periudhe 2 kontrolle teknike, d.m.th 4 kontrolle teknike në vit.
- Çdo specialitet duhet të realizojë përgjatë çdo periudhe 1 saxho, d.m.th 2 saxho në vit.
- Nxënësit që fillojnë për herë të parë specialitetin në klasë të parë (1), në klasë të gjashtë (6) dhe në klasë të dhjetë (10) NUK zhvillojnë saxho dhe kontroll teknik në periudhën e parë (I). Vlerësimi në këto klasa do të jetë i vazhdueshëm nga mësuesi i specialitetit.
- Në fund të periudhës së (II) nxënësi zhvillon provimin përfundimtar (saxho) .

*Shënim:* Vlerësimi i nxënësve kryhet nga një komision, i cili përbëhet nga mësues të të njëjtit ekip lëndor. Vlerësimi i nxënësve në kontrolle teknike dhe saxho bëhet nga komisioni ku është i përfshirë dhe mësuesi i lëndës, i cili ka të drejtën e një note. Nxënësit që do të zhvillojnë lëndët me zgjedhje dhe lëndët sekondare klasat (7-8-9) nuk zhvillojnë kontrolle teknike, por vetëm saxho. ***Në rast se nxënësi ka kontestim note, ngrihet një komision tjetër vlerësues .***

Në provimin përfundimtar (saxho) nxënësit e klasës së IX-të vlerësohen nga komisioni përzgjedhës i IA-së .

Në provimin përfundimtar të specialitetit (saxho) dhe provimit të formimit teorik praktik nxënësit e klasës së IX-të, vlerësohen nga komisioni përzgjedhës i IA-së.

Disa kriteret matës që ky komision duhet të mbajë parasysh janë:

- realizimin e veprës që luan ose këndon;
- Memorie artistike gjatë interpretimit;
- Pastërtia intonative e ritmike;
- Stilistika dhe muzikaliteti gjatë ekzekutimit të veprave;
- Impostim e lirshmëri të aparatit vokal, trupit me instrumentin apo përvetësimin të teknikës së frymëmarrjes.

## 6 PROGRAMET LËNDORE

**Dega: MUZIKË**

**Lënda: Solfezh**

**Klasa: 1-9**

Tematikat klasa 1	Rezultatet e të nxënit
<b>Njohja me muzikën</b> <b>Notat në vija e në fusha, vlerat e notave</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- njeh notat në vija dhe në fusha;</li><li>- identifikon vlerat e notave dhe të pushimeve.</li></ul>

<p><b>Çelësi i solit</b> <b>Çelësi i fa-së</b></p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh çelësin e solit dhe të fa-së;</li> <li>- identifikon çelësin e solit dhe të fa-së.</li> </ul>
<p><b>Njohja me notat poshtë dhe mbi pentagram</b></p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh notat poshtë pentagramit dhe mbi pentagram;</li> <li>- realizon ushtrime notat poshtë pentagramit dhe mbi pentagram.</li> </ul>
<p><b>Koha 4/4 3/4/ dhe 2/4</b></p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh vlerën e notës së plotë;</li> <li>- njeh pushimin e plotë;</li> <li>- njeh vlerën e notës gjysmë me pikë;</li> <li>- identifikon pushimin me vlerë tri kohë;</li> <li>- njeh vlerën e notes gjysmë;</li> <li>- njeh pushimin me vlerë gjysmë.</li> <li>- njeh vlerën e notës çerekshe;</li> <li>- identifikon pushimin me vlerë çereksh;</li> <li>- identifikon dhe respekton notën 1/8 tetëshe;</li> <li>- identifikon dhe respekton pushimin 1/8 tetësh;</li> <li>- identifikon pikën e vlerës pas notës 1/8;</li> <li>- realizon ushtrime në kohë të ndryshme.</li> </ul>

<b>Shkalla muzikore</b>	<b>Nxënësi:</b> - njihet me shkallën do+, arpezhin.
<b>Toni dhe gjysmë toni</b>	<b>Nxënësi:</b> - njih largësinë ton dhe gjysmë ton; - përcakton largësinë ton dhe gjysmë ton.
<b>Tematikat klasa 2</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>Lartësia e tingujve</b> <b>Shkrimi muzikor</b> <b>Rikujtesë</b>	<b>Nxënësi:</b> - njih vlerat ritmike 4/4, 3/4, 2/4; - përcakton pikën e vlerës; - krijon duke përdorur ngjyrat muzikore; - njih shenjat e përsëritjes; - njih vlerat e thjeshta dhe vlerat e përbëra; - identifikon figurat ritmike me pikë.
<b>Shenjat e përsëritjes</b>	<b>Nxënësi:</b> - njih shenjat e përsëritjes; - identifikon shenjat D.C al Fine dhe Korona.
<b>Figurat e ndryshme ritmike, me pikë ose jo</b>	<b>Nxënësi:</b> - njih vlerat e thjeshta dhe vlerat e përbëra;

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- një figurat ritmike me pikë;</li> <li>- një arpezhin e shkallës do+ tetrakordi;</li> <li>- interpreton shkallën Do+;</li> <li>- përdor dhe këndon shenja e shartimit #, b, bekuadër;</li> <li>- identifikon dhe respekton notën 1/16 dhe pushimin 1/16;</li> <li>- identifikon figura ritmike 1/8 dhe dy 1/16;</li> <li>- një Nota e njëjtë me dy emra;</li> <li>- realizon krijim me figura ritmike me pikë e kombinime 1/16, 1/8, 1/4 etj.;</li> <li>- një shenjat D.C al Fine dhe Korona.</li> </ul>
<b>Shkallët maxhore</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- një shkallët maxhore me 1 shenje;</li> <li>- përcakton shkallën Sol+, me 1#, arpezhi;</li> <li>- ndërton shkallën Fa+, me 1b, arpezhi;</li> <li>- interpreton shkallët maxhore.</li> </ul>
<b>Shkallët minore</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- një shkallet minore me 1 shenjë;</li> <li>- një shkallën mi-, me 1#, arpezhi;</li> <li>- realizon shkallën re-, me 1b, arpezhi;</li> <li>- interpreton shkallët minore.</li> </ul>

<b>Shenjat e shartimit</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh shenjën #, b, bekuadër dhe funksionin e tyre në muzikë;</li> <li>- identifikon shenjat e aksidentit në partitura muzikore.</li> </ul>
<b>Ngjyrat muzikore</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh ngjyrat muzikore pp, p, mf, f, ff;</li> <li>- identifikon dhe respekton crescendo, decrescendo;</li> <li>- krijon ushtrime melodike duke përdorur shenjat e ngjyrimit.</li> </ul>
<b>Tematikat klasa 3</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>Rikujtesë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkallët + dhe – në tri forma dhe ndërtimi i tyre</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikon shkallën Do+ Sol+ Fa+;</li> <li>- realizon krijim muzikore, duke përdorur toni e ½ toni;</li> <li>- njeh vlerat dhe figurat ritmike;</li> <li>- përdor në krijim muzikor shpejtësitë e kohëve. Thekset;</li> <li>- identifikon shkalla La- , 3 format e minorit;</li> <li>- ndërton shkalla Mi- , 3 format;</li> <li>- këndon shkallën Re- 3 format.</li> </ul>
<b>Shkallët maxhore e minore me 2 shenja diferencë</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh shkallën Re + me 2 diezis;</li> <li>- identifikon shkallën si- me 3 forma;</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- krijon ushtrime duke përdorur shkallën si-;</li> <li>- njeh shkallën Sib + me 2 bemola;</li> <li>- njeh shkallën sol- me 3 forma.</li> </ul>
<b>Figura muzikore</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh figurën e sinkopës;</li> <li>- njeh figurën e trioleti.</li> </ul>
<b>Kohët muzikore</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh metrin <math>2/8</math>, <math>3/8</math>, <math>4/8</math>;</li> <li>- njeh metrin <math>2/2</math>, <math>3/2</math>, <math>4/2</math> ;</li> <li>- identifikon dhe krijon ushtrime në metrat e dhënë.</li> </ul>
<b>Tematikat klasa 4</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>Rikujtesë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Trioleti</li> <li>- Sinkop</li> <li>- Shkallët</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbaton gjatë ushtrimeve simbolet e trioletit dhe sinkopës;</li> <li>- këndon shkallën muzikore në ngjitje dhe zbritje.</li> </ul>
<b>Kohët e përbëra <math>6/8</math>, <math>9/8</math>, <math>12/8</math></b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh kohët e përbëra në metrin trinar <math>6/8</math>, <math>9/8</math>, <math>12/8</math>.</li> </ul>
<b>Shkallët + e – me 3 shenja diferencë</b>	<b>Nxënësi:</b>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh shkallën La+, fa#- në tri forma;</li> <li>- realizon shkallën Mib+, do- në tri forma;</li> <li>- krijon ushtrime duke përdorur shkallët e mësipërme.</li> </ul>
<b>Konvencionet</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh konvencionet në solfezh, piano;</li> <li>- zbaton konvencionet në: violinë, pedali, harkatat.</li> </ul>
<b>Shenjat e shartimit</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh dubëldiezin x;</li> <li>- njeh dubëlbemolin bb;</li> <li>- njeh gjysmëtonin kromatik;</li> <li>- njeh gjysmëtonin diatonik;</li> <li>- përcakton gjysmëtonin kromatik e diatonik.</li> </ul>
<b>Tematikat klasa 5</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<p><b>Rikujtesë.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Figurat ritmike.</li> <li>- Shkallët + dhe -</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikon shkallët + me 3 # e b të mësuara;</li> <li>- identifikon shkallët përkatëse – me 3 forma;</li> <li>- krijon ushtrime duke përdorur figurën e Sinkopës dhe figura të ndryshme ritmike.</li> </ul>

<b>Intervalet</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh Intervalet e thjeshta. Prima;</li> <li>- njeh Intervalet e thjeshta. Sekonda ;</li> <li>- njeh Intervalet e thjeshta. Terca;</li> <li>- njeh Intervalet e thjeshta. Kuarta;</li> <li>- njeh Intervalet e thjeshta. Kuinta;</li> <li>- ndërton intervale të thjeshta.</li> </ul>
<b>Shkallët + dhe -</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh shkallën Mi + me 4 diezis;</li> <li>- njeh shkallën do#- me 3 forma;</li> <li>- njeh shkallën Lab+ me 4 bemola;</li> <li>- njeh shkallën fa- me 3 forma;</li> <li>- ndërton shkallët muzikore maxhore e minore me 4 shenja.</li> </ul>
<b>Format muzikore</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh formën e periudhës;</li> <li>- njeh formën më të thjeshtë muzikore;</li> <li>- identifikon periudhën muzikore;</li> <li>- krijon një frazë në formë periudhe.</li> </ul>
<b>Figurat ritmike</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p>

Tematikat klasa 6	Rezultatet e të nxënit
<b>Rikujtesë</b> - Intervalet - Sinkopa	<b>Nxënësi:</b> - aftësohet në intervalet nga I1 deri tek I5; - përvetëson figura të ndryshme ritmike; - identifikon figurën e sinkopës.
<b>Intervalet. I6deri tek I8</b>	<b>Nxënësi:</b> - njih intervalet e thjeshta. Seksta I6; - identifikon intervalet e thjeshta SeptimaI7; - njih intervalet e thjeshta. Oktava I8.
<b>Akordi</b>	<b>Nxënësi:</b> - njih akordin, ndërtimi dhe llojet e tij; - njih kuintakordi dhe llojet e tij; - ndërton kuintakordin dhe llojet e tij.
<b>Shkallët + dhe -</b>	<b>Nxënësi:</b> - njih Shkallën Si + me 5diezis; - njih Shkallën sol#- me 3 forma; - njih Shkallën reb+ me 5 bemola;

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh Shkallën sib- me 3 forma;</li> <li>- ndërton Shkallët me 5 shenja diferencë.</li> </ul>
<b>Ritmika</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh ritmikën. Grupet e çrregullta;</li> <li>- krijon ushtrim ritmik;</li> <li>- identifikon grupet e çrregullta.</li> </ul>
<b>Format muzikore</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh motivin, frazën, temën muzikore;</li> <li>- identifikon përmes dëgjimit formën 2- pjesëshe e thjeshtë;</li> <li>- identifikon formën 2-pjesëshe në partitura.</li> </ul>
<b>Tematikat klasa 7</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<p><b>Rikujtesë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ritmika</li> <li>- Akordi A 5</li> <li>- Kuintakordet</li> <li>- Përmbysjet e A5 A6 A64</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon ushtrime me akorde;</li> <li>- ndërton A5 dhe përmbysjet: A5, A6, A64.</li> </ul>
<b>Kohët</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- lexon ushtrime në kohët e përziera 5/8, 5/4, 7/8, 7/4, 9/8, 9/4, 12/8,</li> </ul>

	12/4.
<b>Shkallët + dhe -</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh Shkalla Fa# +;</li> <li>- njeh Shkalla re#- me 3 forma;</li> <li>- njeh Shkalla Solb+;</li> <li>- identifikon Shkallën mib- me 3 forma;</li> <li>- njeh Shkallën Dob+;</li> <li>- ndërton Shkallën lab- me 3 forma;</li> <li>- njeh Rrethi i kuintave;</li> <li>- njeh Modet diatonike.</li> </ul>
<b>Format muzikore</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh formën 3- pjesëshe e thjeshtë;</li> <li>- identifikon formën 3- pjesëshe e thjeshtë.</li> </ul>
<b>Tematikat klasa 8</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>Rikujtesë. Figurat ritmike</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përvetëson figura me vlera të ndryshme ritmike.</li> </ul>
<b>Çelësat</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh sistemin e çelësave ;</li> <li>- njeh Çelësin e tenorit;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh Çelësin e kontraltit, altit;</li> <li>- njeh Çelësin e sopranos;</li> <li>- njeh Çelësin e mexo/sopranos;</li> <li>- njeh Çelësin e baritonit;</li> <li>- identifikon dhe përcakton oktavat;</li> <li>- identifikon dhe emërton notat sipas alfabetit.</li> </ul>
<b>Zgjidhjet e tingujve</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh modin maxhor 3 format;</li> <li>- identifikon shenjat e shkurtimit;</li> <li>- njeh Intervalet e thjeshta e të përbëra;</li> <li>- përcakton zgjidhjen e tingujve sipas gradëve të qëndrueshme;</li> <li>- njeh Dominant septakordin;</li> <li>- ndërton D7 dhe Përmbysjet;</li> <li>- krijon përmbysje e zgjidhje të intervaleve;</li> <li>- identifikon tingujt, intervalet e tonalitetet harmonike;</li> <li>- krijon duke përdorur shenjat e zburimit.</li> </ul>
<b>Dominant septakordi D7 dhe Përmbysjet</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh Dominant septakordin, zgjidhja;</li> <li>- krijon ushtrime me përmbysjet e D7 dhe zgjidhjet.</li> </ul>

<b>Format muzikore</b>	<b>Nxënësi:</b> - njeh motivin, frazën, temën muzikore; - identifikon miniaturat si forma 2-3 pjesëshe.
<b>Tematikat klasa 9</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>Figurat ritmike</b>	<b>Nxënësi:</b> - përvetëson figura me vlera të ndryshme ritmike.
<b>Ritmet e përziera</b>	<b>Nxënësi:</b> - njeh ndërtimin e A5 dhe D7 me përmbysje; - njeh kohën/metrin 9/4 e 9/8; - shkalla kromatike; - koha/metri i përzier 12/4 e 12/8; - njeh çelësat e altit e tenorit; - njeh çelësat e sopranit, mexosopranit; - njeh çelësin e baritonit.
<b>Ndërtimi i akordeve</b>	<b>Nxënësi:</b> - njeh akordet mbi 7 gradët e shkallës; - identifikon akordet maxhore TSD; - njeh akordet minore, septakordin; grupet e çrregullta; melizmat; - krijon përmbysje e zgjidhje të intervaleve;



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikon tingujt, intervalet e tonalitetet harmonike;</li> <li>- krijon duke përdorur shenjat e zburimit.</li> </ul>
<b>Format muzikore</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh minuetin, fugën, etydin;</li> <li>- identifikon miniaturat si forma 2-3 pjesëshe.</li> </ul>
<b>UDHËZIME METODOLOGJIKE:</b>  <b>Gjatë procesit mësimor në lëndën solfezh, mësuesi në çdo orë duhet:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të bëjë dëgjime melodike për të zhvilluar veshin melodik;</li> <li>- të japi ushtrime leximi dhe këndimi;</li> <li>- të punojë ushtrime jashtë tekstit;</li> <li>- të përforcojë njohuritë e marra;</li> <li>- të zhvillojë diktate melodike e ritmike;</li> <li>- të punojë veçmas figura ritmike.</li> </ul>	
<b>UDHËZIME PËR VLERËSIMIN</b>  <b>Nxënës/i,-ja është i nivelit të MJAFTUESHËM, kur:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh çelësat muzikore;</li> <li>- lexon ushtrime me figurat ritmike të mësuara.</li> </ul> <b>Nxënës/i,-ja është i nivelit MIRË, kur:</b>	

- njeh çelësat muzikor dhe lexon ushtrime me to;
- njeh figura të ndryshme ritmike dhe me kombinime kohësh e vlerash;
- lexon ushtrime me figurat ritmike të mësuara;
- njeh septakordin;
- realizon pjesërisht diktatet melodike e ritmike.

**Nxënës/i,-ja është i nivelit SHUMË TË MIRË, kur:**

- njeh dhe lexon ushtrime me çelësa të ndryshëm;
- këndon ushtrime melodike në çelësa të ndryshëm;
- realizon diktate melodike e ritmike;
- lexon ushtrime a prima vista;
- këndon ushtrimet duke respektuar shenjat e ngjyrimet.

**Materiale dhe burime mësimore:**

- Diktate melodike Llaudin;
- Diktate melodike Noel Gallon.

**Dega: MUZIKË**

**Lënda: Edukim koral**

**Klasa: 1-9**

Tematikat klasa 1-9	Rezultatet e të nxënit
<ul style="list-style-type: none"><li>- Hyrje në lëndën e klasës Korale:</li><li>- Kori, llojet, roli dhe rëndësia</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- njeh formacionet korale dhe rëndësinë që ka kori në jetën e një artisti, si dhe në jetën sociale;</li><li>- mëson llojet e formacioneve korale, me shoqërim dhe acapella.</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Frymëmarrja</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- njeh rolin që ka frymëmarrja gjatë këndimit në ansamblin koral; praktikon teknikën e frymëmarrjes si elementi më i rëndësishëm i të kënduarit në kor.</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Warm up – Vokalizat ( I-V)</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- njeh rolin që ka ngrohja(Warm up) fizike në përgatitjen e trupit si instrumenti që do të këndojë;</li><li>- ushtron rolin e ngrohjes së kordave vokale(Vokalizat) në procesin përgatitor për të përballuar e kënduar repertorin e përcaktuar nga mësuesi Dirigjent.</li></ul>

<p>- Intonacioni (I-IX)</p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kupton rëndësinë e të kënduarit i intonuar, nëpërmjet ushtrimeve vokale, këngëve korale.</li> </ul>
<p>- Këngët unison(Kl. I, II, III )</p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- këndon i unifikuar në të njëjtin zë(zërat janë të bardhë), dhe ka shumë rëndësi vetëm intonacioni dhe ritmi i unifikuar.</li> </ul>
<p>- Këngët kanon me 2,3 dhe katër zëra. (I-IX)</p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- unifikohet të këndoje elementet e para të shumëzërëshit nëpërmjet kanonit.</li> </ul>
<p>- Këngët me dy, tre dhe katër zëra (Kl. IV-IX)</p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- këndon në mënyrë harmonike, këngë të ndryshme me dy, tre dhe katër zëra;</li> <li>- *Ky është dhe momenti i kapërcimit të vështirësisë të kënduarit deri në katër zëra menjëherë duke krijuar një bashkëtingëllim estetik dhe artistik.</li> </ul>

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

- Për të arritur një përvetësim me nivel të lartë dhe me 1, 2,3 dhe 4 zëra, në mësimin, përvetësimin dhe aftësimin e të kënduarit në kor, mësuesi i lëndës:
- zgjedh ushtrime vokale e këngë korale;
- zhvillon në mënyrë praktike mësimin;
- kërkon nga çdo nxënës mësimin e koncepteve të qarta të teknikës së frymëmarrjes, vokalizave;
- kërkon këndimi e impostuar Voce Bianca(Zërat e Bardhë).
- Mësuesi Dirigjent i lëndës së klasës Korale, mund ta organizojë orën e mësimin, sipas klasave, specialiteteve dhe niveleve të nxënësve. Nxënësit fillestarë së bashku dhe nxënësit që vazhdojnë lëndën e klasës korale, së bashku.

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

### Niveli SHUMË MIRË

#### Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:

- praktikon teknikën e frymëmarrjes, Vokalizat, si dhe ushtrimet e teknikes vokale të zgjedhur nga mësuesi i lëndës;
- këndon në një ansambël vokal e koral me 1,2,3,4 zëra, duke mësuar të jetë i sigurt në intonacion dhe ritëm duke kënduar me pasion këngët e zgjedhura nga mësuesi i lëndës.

### Niveli MIRË

#### Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:

- përvetëson me saktësi teknikën e frymëmarrjes dhe rëndësinë e saj gjatë të kënduarit në kor;
- këndon me siguri në ansamblin koral.

## **Niveli MJAFTUESHEM**

### **Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- këndon këngët me 1,2,3,4 zëra, duke mos u orientuar.

### **Materiale dhe burime mësimore:**

- vepra të thjeshta vokale e korale të epokave, traditave, kompozitorë të vendeve të ndryshme, të cilat janë të përshtatshme për grupmoshën dhe nivelin konkret të ansambleve vokale e korale;
- pjesë korale, mbi bazën e nivelit të çdo klase korale;
- këngë korale nga Kompozitorët : W.A.Mozart, L.V.Beethoven, R.Schumann, J.Brahms, N.Zoraqi, B.Kongoli, A.Mula, T.Daija, P.Jakova etj..

**Dega: MUZIKË**

**Lënda: Edukim orkestral**

**Klasa: 1-9**

<b>Tematikat klasa 1-9</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>Hyrje në lëndën e Orkestër</b>	<b>Nxënësi:</b>

- Ushtrime intonimi dhe sinkronizimi ritmik me tri zëra, me vështirësi graduale:
- Ensemble Method For The Violin – Oscar J. Lehrer –
- (Metodë ansambli që mund të përdoret nga mësuesi dirigjent duke e adaptuar dhe transkriptuar për të gjitha instrumentet orkestrale, e disponueshme në [www.impsl.org](http://www.impsl.org)

- njih llojet e ansambleve orkestrale dhe instrumentet që i formojnë;
- zbërthen partet orkestrale, me saktësi ritmike dhe pastërti intonative;
- krijon bashkëpunim dhe pavarësinë në lojën në orkestrë;
- njih lojën e interpretimit në ansambël duke u bërë kompetent në gjykimin dhe vlerësimin e saj;
- njih mesazhin muzikor dhe stilin e veprës duke i dhënë karakterin e duhur gjatë lojës;
- krijon besimin tek vetja, në rolin që ndërmerr gjatë lojës në ansambël;
- përjeton konkretisht veprat muzikore, përmes interpretimit në ansambël;
- komunikon dhe shprehet nëpërmjet interpretimit muzikor në mënyrë të vazhdueshme duke ndjekur dirigjentin;
- luan në ansambël duke ruajtur balancat e tingëllimit;
- krijon raporte të drejta të tingëllimit në grupin e tij dhe midis grupeve të tjera të orkestrës;
- vendos harkata të sakta duke unifikuar ekzekutimin e të gjitha grupeve për harqet;
- zhvillon punë të detajuar për të pasur një intonacion korrekt;
- njih stile dhe gjini të ndryshme muzikore, sipas karakteristikave të

	<p>periudhës dhe kompozitorëve, duke studiuar dhe interpretuar partet orkestrale në instrumentin e tij;</p> <p>- zotëron karakteristikat e orkestrantit, i cili duhet të luajë në instrument e të dëgjojë njëkohësisht instrumentet rrotull tij.</p>
- Shkallë muzikore me teknika, dinamika dhe temp të ndryshueshëm nga mësuesi që i dirigjon (legato – staccato, forte – piano, accelerando – ritenuto, corona, etj.)	
- Melodi dhe këngë të thjeshta me 2 – 5 zëra, të përshtatura për llojet e instrumenteve që luajnë nxënësit e klasave 1 - 9 përgjatë vitit shkollor	
- Vepra të thjeshta orkestrale dhe përpunime (transkriptime) për orkestër, nga kompozitorë të huaj dhe shqiptarë të periudhave të ndryshme	
<p><b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b></p> <p>- Ushtrime intonimi dhe sinkronizimi ritmik me tri zëra, me vështirësi graduale me mësuesin që i dirigjon.</p> <p>- Ushtrime sinkronizimi në orkestër duke luajtur shkallë muzikore me teknika, dinamika dhe temp të ndryshueshëm nga mësuesi që i dirigjon (legato – staccato, forte – piano, accelerando – ritenuto, corona, etj.).</p> <p>- Sipas periudhës përkatëse mësuesi dirigjent shpjegon stilistikën, specifikat përkatëse dhe karakterin e veprës që nxënësit do të luajnë.</p>	



- Zbërthimi i partiturave në klasë edhe me anë të leximit “a prima vista” për nxënësit më të avancuar.
- Punimi i partëve të grupeve të veçanta në orkestrën frymore për saktësi në vlerat ritmike dhe pasazhet melodike.
- Puna me grupet, duke kërkuar pastërti në intonacion, e më pas, lidhja e të gjitha grupeve.
- Puna me instrumentet frymore për evidentimin e timbrikave të veçanta të çdo grupi në veçanti, si dhe për bashkëtingëllimin e instrumenteve frymorë.
- Punimi i partëve të grupeve të harqeve, duke përcaktuar harkatat.
- Puna me orkestrën frymore për lojën e saktë dhe për evidentimin e karakterit të veprave.
- Nxënësi interpreton në orkestër, duke ndjekur partin orkestral dhe lojën e mësuesit dirigjent.
- Provat orkestrale zhvillohen duke u kujdesur që tempin e veprës gjatë provave të jetë i përshtatshëm për të gjithë nxënësit, deri sa të arrihet siguria e duhur për të luajtur veprën me tempin e saj.
- Sipas numrit të nxënësve instrumentistë që janë në orkestër për vitin shkollor përkatës, mund të përdoren pjesë për formacione më të reduktuara - nga oktetit deri në duo.
- Përzgjedhja e repertorit
- Mësuesi mund të përzgjedhë vepra të thjeshta ose transkriptime për orkestër të stileve dhe epokave të ndryshme, nga periudha baroke deri në muzikën bashkëkohore, duke përfshirë edhe muzikën e kompozitorëve shqiptarë:
- Periudha baroke: Bach, Handel, Corelli, Telemann, Vivaldi e të tjerë.
- Periudha klasike: Haydn, Mozart, Beethoven e të tjerë.
- Periudha romantike: Schubert, Mendelssohn, Tchaikovsky, Rossini, Verdi, Grieg, e të tjerë.
- Periudha moderne dhe bashkëkohore: Briten, Bartok, Dvorak, Holst, Respighi, Gershwin, Williams, Morricone e të tjerë; Përpunime të thjeshta për orkestër të këngëve të njohura dhe hite aktuale ndërkombëtare.
- Muzika shqiptare: Jakova, Zadeja, Daija, Gjoni, Gaci, Harapi, Zoraqi, Simoni, Ibrahim, Laro, Kushta, Dizdari, Peci, Lalo, Krajka, Zaharjan,

- I. Shehu, Tole, Sina, Kraja, Naçi, Cene e të tjerë; Përpunime të thjeshta për orkestër të këngëve të njohura dhe hite aktuale shqiptare.
- Repertori mund të përzgjidhet edhe sipas kërkesave artistike që mund të lindin për realizimin e koncerteve dhe aktiviteteve që organizon shkolla në kuadër të festave zyrtare apo evenimenteve të ndryshme (binjakëzimet midis shkollave, festivale, etj.)
  - Literaturë: Ensemble Method For The Violin – Oscar J. Lehrer (Metodë ansambli që mund të përdoret nga mësuesi dirigjent duke e adaptuar dhe transkriptuar për të gjitha instrumentet orkestrale, e disponueshme në [www.impsl.org](http://www.impsl.org) )

## **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

### **Niveli MJAFTUESHEM**

#### **Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njeh dhe luan me saktësi të mjaftueshme partin e tij pas përfundimit të të gjitha provave orkestrale të çdo vepre;
- ruan mjaftueshëm balancat në tingëllim;
- ruan mjaftueshëm raportin e tingëllimit midis tij, grupit të tij dhe grupeve të tjera orkestrale;
- i afrohet me lojën e tij karakterit të veprave;
- ndjek mjaftueshëm njëkohësisht partin orkestral dhe gjestet e mësuesit dirigjent.

### **Niveli MIRË**

#### **Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njeh mirë dhe luan partin e tij pas përfundimit të të gjitha provave orkestrale të çdo vepre;
- ruan mirë balancat në tingëllim;
- ruan raportin e tingëllimit midis tij, grupit të tij dhe grupeve të tjera orkestrale;
- thekson mirë karakterin e veprave dhe muzikalitetin e pjesëve të veçanta;

- ndjek mirë njëkohësisht partin orkestral dhe gjestet e mësuesit dirigjent.

### **Niveli SHUMË MIRË**

#### **Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njih shumë mirë dhe luan saktë partin e tij pas përfundimit të të gjitha provave orkestrale të çdo vepre;
- ruan shumë mirë balancat në tingëllim;
- ruan shumë mirë raportin të tingëllimit midis tij, grupit të tij dhe grupeve të tjera orkestrale;
- thekson shumë mirë karakterin e veprave dhe muzikalitetin e pjesëve të veçanta;
- ndjek shumë mirë njëkohësisht partin orkestral dhe gjestet e mësuesit dirigjent.

#### **Materiale dhe burime mësimore:**

- lexhio për provat e orkestrës;
- partiturat e kompozitorëve të huaj të periudhave të ndryshme (të botuara ose të disponueshme në [www.imslp.org](http://www.imslp.org));
- partiturat e kompozitorëve shqiptarë të periudhave të ndryshme; (të botuara ose të disponueshme në bibliotekën e Universitetit të Arteve)
- shembuj audio - video të veprave që do të luhen, të marra nga: Cd - Dvd të ndryshme; nga interneti; nga biblioteka online e Universitetit të Arteve.

**Dega : Muzikë**

**Lënda: Piano**

**Klasa: 1-9**

Tematikat klasa 1	Rezultatet e të nxënit
<p><b>Njohja me instrumentin dhe shprehjtë fillestare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Marrja e tingullit non legato, pastaj legato dhe stacato</li><li>- Harapi: Trëndafili i vogël; Prelud</li><li>- Avrazi: Atdheu</li><li>- Dizdari: Pjese të vogla; Etyde</li><li>- Shtuni: Variacione mbi një temë popullore</li><li>- Nikoleva: Luajtja në piano</li><li>- Gnesina: Abc-Ja e pianos</li><li>- Beyer: Shkolla per piano</li><li>- Bastien: Niveli fillestar i pianos</li><li>- Thompson: Libri i pare</li><li>- Czerny: Etyde op.599</li><li>- Gedike: Etyde te vogla</li><li>- Bartok: Mikrokozmos (pjesë të vogla)</li><li>- Diabelli: Pjese melodike op.149 për 4 duar</li><li>- Cesi: Czerny e Diabelli për 4 duar</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- realizon impostimin e duarve në piano;</li><li>- realizon impostimin e qëndrimit në piano;</li><li>- bën alternimin e duarve dhe saktëson nocionet për të dyja duart;</li><li>- përvetëson lojën në instrument me të gjithë elementet;</li><li>- përvetëson nocionet ritmike përmes vlerave të notës gjysmë, ¼, 1/8, 1/8 me pikë vlere;</li><li>- përvetëson njohuri dhe koncept mbi tempin, organizimin e frazës dhe shenjat dinamike.</li></ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Schytte: Complete Jazz Piano for young pianist</li> </ul>	
<b>Tematikat klasa 2</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ushtrime gishtash</li> <li>- Ushtrime nga Bastien: metoda e dytë dhe e tretë</li> <li>- Ushtrime nga Thompson: metoda e dytë dhe e tretë</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- pasuron njohuritë e tij nëpërmjet programit që do të luaj;</li> <li>- përvetëson pasazhet mbi figurat dhe grupe të shumëllojshme;</li> <li>- zhvillon fuqinë dhe ruan stabilitetin e gishtave;</li> <li>- përmirëson impostimin në kohë.;</li> <li>- realizon gjatë lojës në instrument, figura të ndryshme ritmike;</li> <li>- merr njohuritë e para të polifonisë;</li> <li>- merr njohuritë fillestare mi përdorimin e pedalit.</li> </ul>
<p><b>4 shkallë maxhore me 2 dhe 3oktava, arpezhe dhe akorde, (sol major, re major, la major, mi major)</b></p> <p><b>8 ushtrime të ndryshme nga:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gnesine: Etyde të vogla, pjesa e parë</li> <li>- Bayer: Etyde</li> <li>- Gedike: Etyde</li> <li>- Dizdari: Etyde</li> <li>- Schytte: Etyde</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillon më tej impostimin e të dy duarve, bazuar tek ndjeshmëria dhe natyrshmëria;</li> <li>- zhvillon një disiplinë të studimit në instrument për arritjen tingullore, intonative dhe ritmike;</li> <li>- realizon gjatë luajtjes në instrument, termat e dinamikës (shenjat e ngjyimit, theksat, portato, stakato, detashe, legato);</li> <li>- përvetëson konceptet e dinamikës dhe të teknikave të përdorura;</li> </ul>

- Berens: Etyde, opus 70
- J.S. Bach: Minuete, Prelude.
- Kunc: 200 kanone të shkurtra.
- Lahovitskaja: (Permbledhje nga Hendel, Koreli, Kriger etj).
- Beethoven: Sonatina G Dur
- Mozart: Variacione G Dur
- Clementi: Sonatina C Dur, nr.1, 2
- Kuhlau: Sonatina Op. 33 nr.1,2
- Haslinger: Sonatina
- Raineke: Sonatina
- Zadeja: Valle; Tregimi i gjyshes
- Daija: Vals
- Ibrahim: Pjese lirike; Tokatina; Prelud
- Ibrahim: Ne aksion; Lepurushi i vogel
- Harapi: Prelud
- Agolli: Pjesë me 4 duar
- Tchaikovsky: Pjesë për fëmijë
- Thompson: Metoda e dytë, e tretë
- Bartok: Mikrokozmos libri 1
- Gedike: Pjese op.36
- Schumann: Pjese op.68

- zhvillon nocionin e tempit më të shpejtë;
- përvetëson elementin e ri, si p.sh “trilin’.
-

- C.Frank: Ankesa e nje kukulle	
<b>Tematikat klasa 3</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>4-5 shkallë Majore dhe Minore, (Fa Major, Re Minor, La Minor, La Major, Mi Major)</b>	<b>Nxënësi:</b>
<b>8 ushtrime të ndryshme nga:</b>	- zhvillon më tej impostimin e të dy duarve, bazuar tek ndjeshmëria dhe natyrshmëria;
- Czerny: Etyde Opus 849	- zhvillon një disiplinë të studimit në instrument për arritjen tingullore dhe ritmike;
- Lemoine: Etyde Opus 37	- realizon gjatë lojes në instrument, termat e dinamikës (shenjat e ngjyrimit, theksat, portato, stakato, legato);
- Bertini: Etyde Opus 100	- përvetëson konceptet e dinamikës dhe të teknikave të përdorura.
- Duvernoy: Etyde Opus 176	- zhvillon nocionin e tempit më të shpejtë.
- Gedike: Etyde Opus 32, Op. 47	- përvetëson elementin e ri, si psh “trilin’
- Lak: Etyde Opus 172	- zhvillon horizontin rreth konceptit muzikal të veprave me përmasa pak më të mëdha .
- Bach: Prelude të vogla	- ndjeshmëria dhe natyrshmëria;
- Bach: Minuete	- zhvillon një disiplinë të studimit në instrument për arritjen tingullore dhe ritmike;
- Bach: Kompozime të vogla	- realizon gjatë lojes në instrument, termat e dinamikës (shenjat e ngjyrimit, theksat, portato, stakato, legato);
- R.Sokoli: Kanone	- përvetëson konceptet e dinamikës dhe të teknikave të përdorura.
- Clementi: Sonatina	
- Kuhlau: Sonatina	
- Kuhlau: Variacione G Dur	
- Diabelli: Sonatina	

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kabalevsky: Variacione Fis Dur Op. 51</li> <li>- Gnesina: Temë me 6 variacione</li> <li>- Harapi: Kompozime për pianist të rinj</li> <li>- Zadeja: Valle; Në aksion</li> <li>- Ibrahim: Valle; Bariu i vogël</li> <li>- Schumann: Album për fëmijë</li> <li>- Bartok: Mikrokozmos libri 2</li> <li>- Haydn: Lojra të vogla</li> <li>- Mozart: 14 Pjese për fëmijë</li> <li>- Tchaikovsky: Album për të rinj op.39</li> <li>- Diabelli: 2 Sonatina</li> <li>- Stravinsky: 5 Pjesë të vogla</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillon nocionin e tempit me te shpejte.</li> <li>- Perveteson elementin e ri, si psh “trilin’</li> <li>- Zhvillon horizontin rreth konceptit muzikal te veprave me permasa pak me te medha</li> </ul>
<b>Tematikat klasa 4</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
- Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigorozë. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik e emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psikoemocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënit dhe rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do ta bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin. Puna e diferencuar, mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi, do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecurisë së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij në lidhje me programin, në individë që e përvetësojnë atë më shpejt. Materiali didaktik duhet t'i përgjigjet nivelit që kërkon grupmosha e jo nivelit të ulët, po ashtu edhe programi artistik. Për këtë arsye bëhet zberthimi i programit nga çdo mësues për çdo muaj dhe i miratuar nga drejtuesi specialist i shkollës. Përgatitja e nxënësit duhet të bëhet e kontrolluar edhe me variante të ndryshme për të pasur më shumë efektivitet. Gjatë zhvillimit të orëve të para, materiali teknik dhe didaktik të kërkohet në një ritëm të ngadaltë dhe duke avancuar në tempin real. Kërkesat bazë, si: përpikëria në ritëm, konceptimi i frymëmarrjes mbi bazën e logjikës konceptuale muzikore e teknike, realizimi i aplikaturave dhe loja me koncept të drejtë me tingull të pastër, përbëjnë elementet kryesore të suksesit dhe të arritjes së rezultateve optimale.

**Shënim.** Materiali artistik, ku përfshihen koncertet dhe sonatat, veprat ciklike, mund të zëvendësohet nga ana e mësuesit të lëndës me materiale të tjera, por ato të jenë në të njëjtën shkallë vështirësie dhe të miratohen nga komisioni përkatës.

### **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

#### **Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan jo korrekt;
- me ritëm;
- me tingull mesatar;
- me intonacion jo të këndshëm;
- me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

#### **Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan mirë;
- ritmikiht;
- me tingull e me intonacion, pastër e me pak gabime.

#### **Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Saxon, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet.

**Dega: MUZIKË**

**Lënda: Kontrabas**

**Klasa: 6-9**

Tematikat klasa 6	Rezultatet e të nxënit
<ul style="list-style-type: none"><li>- Tërheqje harku me vlera të ndryshme në 4 telat</li><li>- Ushtrime gishtash</li><li>- Klengel (Ushtrime Teknike)(Metodë për fillestare)</li></ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- realizon impostimin e duarve dhe të harkut;</li><li>- realizon tërheqje harku të qetë me njëtrajtshmëri dhe pastërti të tingullit në të katër telat;</li><li>- vendos dorën e majtë sa më drejt për të forcuar artikulationin.</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- 4-5 shkallë minore ose maxhore me 1 oktavë me nga dy arpezhe dhe me forma të ndryshme nga Metoda “ Materiale teknike” Luigj Lazri</li></ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- zhvillon edukimin e veshit dhe intonacionit përmes ekzekutimit të shkallëve muzikore;</li><li>- forcon artikulationin e dorës së majtë.</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Ushtrime nga Metoda “ Materiale teknike” Luigj Lazri (Metode fillestare për cello)</li></ul>	<b>Nxënësi:</b>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Essential Elements for string</li> <li>- 5-6 kompozime me piano</li> <li>- Marderowsky (Metodë me shoqërim në piano)</li> <li>- (Repertor përmbledhës)</li> <li>- Suzuki -Volumi I</li> </ul>	<p><b>kupton lojën teknike hap pas hapi, duke përdorur Ushtrime dhe etyde të ndryshme;</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon impostimin e duarve në Kontrabas;</li> <li>- realizon impostimin e harkut;</li> <li>- kryen bashkimin e duarve dhe bën saktësimin e nocioneve për të dyja duart;</li> <li>- vendos gishtat në të katër telat në pozicionin e parë;</li> <li>- përvetëson lojën në instrument me të gjithë elementet;</li> <li>- përvetëson nocionet ritmike përmes vlerave të notës gjysmë, 1/4, 1/8, 1/8 me pikë vlere;</li> <li>- zhvillon më tej reflekset manuale;</li> <li>- përmirëson impostimin në kohë.</li> </ul>
<p><b>Tematikat klasa 7</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Tërheqje harku me vlera të ndryshme në 4 telat</li> <li>- Klengel-Ushtrime gishtash</li> <li>- Docauer- Ushtrime Teknike (Volumi</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ushtrohet çdo ditë me ushtrime me qëllim formimin e tingullit dhe të artikulacionit të gishtave;</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- 6 shkallë minore ose maxhore nga Metoda Materiale teknike” Luigj Lazri dhe ushtrime për dorën e majtë (1-2 shkallë me 2 oktava)</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon nëpërmjet lojës në instrument intonacion sa më të pastër;</li> <li>- organizon njohuritë e marra gjatë luajtjes në instrument;</li> </ul>

	- ushtrohet në realizimin e frazës, ngjyrës, dinamikës.
- 8 ushtrime (etyde) - Mësimet fillestare të Kontrabasit ( në vazhdim)	<b>Nxënësi:</b> - realizon nëpërmjet materialit teknik, hap pas hapi, teknikat figura të ndryshme - përvetëson gjysmëtonin ndërmjet gishtit 0-1, 1-3, si dhe 2-4
- 5-6 kompozime me piano - Suzuki-Volumi I-II - Marderowsky-repertor përmbledhës. etj.	<b>Nxënësi:</b> - ushtrohet në realizimin e frazës, ngjyrës, dinamikës; - realizon vibraton; - zgjeron njohuritë për mënyrat e përdorimit të harkut duke ruajtur tingëllimin e pandërprerë muzikor; - organizon njohuritë e marra gjatë luajtjes në instrument.
<b>Tematikat klasa 8</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
- Klengel-ushtrime gishtash - Shevcik-ushtrime per perdorimin e harkut	<b>Nxënësi:</b> - realizon çdo ditë ushtrime me qëllim formimin e tingullit dhe artikulacionit të dorës së majtë. - ushtrohet në realizimin e frazës, ngjyrës, dinamikës.
- 4-5 shkallë me 2 oktava pozicioni I dhe - IV me arpezhe dhe legatura të ndryshme	<b>Nxënësi:</b> - fiton reflekse për shkathtësimin e aparatit dhe për intonacion të



<ul style="list-style-type: none"> <li>- Essential Elements: Volumi II ( shkallë për kontrabas)</li> </ul>	<p>pastër;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ushtrohet çdo ditë me ushtrime me qëllim formimin e tingullit dhe të artikulacionit të gishtave.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- 8 etyde të ndryshme nga:</li> <li>- Luigj Lazri</li> <li>- Docauer</li> <li>- Lee: 12 etyde të zgjedhura</li> <li>- Essential Elements (Volumi 2)</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon etyde duke u pasuruar me teknika të reja;</li> <li>- ushtrohet në arritjen e pastërtisë intonative dhe tingullore, nëpërmjet disiplinave ndihmëse, si: tërheqje harku me kohëzgjatje të përcaktuar (4- 8 kohë ) dhe ushtrime gishtash Klengel;</li> <li>- krijon pavarësi në lëvizjen e gishtave dhe në realizimin e gjysmëtonit;</li> <li>- përvetëson lojën në pozicionin e parë dhe të katërt.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Suzuki-( Volumi II-III)</li> <li>- Marderowsky - (Volum me pjesë)</li> <li>- Bakllanova</li> <li>- Bukinik</li> <li>- KujtimLaro</li> <li>- Moxart, Hendel etj.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon vibraton si një element bazë për të shprehur muzikalitetin;</li> <li>- realizon teknikat e fituara gjatë luajtjes në instrument;</li> <li>- gërsheton kërkesën e mësuesit me instiktin muzikal individual.</li> </ul>
<p><b>Tematikat klasa 9</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Klengel: ushtrime gishtash</li> <li>- Docauer: ushtrime</li> <li>- Bille (Metodë për Kontrabas)</li> <li>- Shevçik: opus.1,3 (Ushtrime për kolpet e harkut)</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mban duart në formë me ushtrime gishtash dhe përgatitet për bashkëtingëllim të pastër intonativ.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- 6 shkallë minore ose maxhore me pozicion I-II-III, me arpezhe përkatëse të luajtura me harkata të ndryshme</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ushtrohet në shkallë për të fituar reflekse manuale.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- 8 etyde me teknika të ndryshme nga:</li> <li>- Luigj Lazri- (metodë me etyde për pozicionin e katërt)</li> <li>- Lee –12 etyde të zgjedhura</li> <li>- Essential Elements- etyde Volumi -II-III</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon artistikisht etydet;</li> <li>- përvetëson pastërtinë e kalimeve;</li> <li>- praktikon dendur kalimet e pozicioneve;</li> <li>- përvetëson disa kolpe të përdorimit të harkut.</li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>8 pjesë nga autorë;</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Suzuki-( Volumi II-III)</li> <li>- Marderowsky-(Metodë për cello dhe piano)</li> <li>- Klengel (Koncert)</li> <li>- Marcello (sonata)</li> <li>- Kujtim Laro</li> <li>- Bach (Suita për cello Solo)</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përvetëson pastërtinë e tingullit;</li> <li>- vibron dhe organizon gjatë lojës në instrument frazën muzikore.</li> </ul>

- Suzuki: (Volumi III-IV) etj.

### **UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Nxënësi në këtë fillim cikli duhet të ketë fituar mjaft elemente primare të shkollimit, si i sensit të punës së detajuar, nga detyrat që merr nga mësuesi, mënyrën e studimit.

Nxënësi duhet të radhisë studimin me tërheqje harku në tela bosh, ushtrime ditore të gishtave, shkallët me gjithë kompleksitetin e kërkesave si dhe kërkesat që kanë ushtrimet dhe pjesët në drejtim të realizimit total.

**Mësuesi mbetet shumë i rëndësishëm, pasi duhet të shpjegojë me kritere të drejta dhe vendosjen e dorës së majtë në pozicionet e reja.**

Në këtë cikël mësuesi duhet të kërkojë një tingull më të ngjeshur e më të plotë, gjithashtu të kërkojë dhe vibrato me pretendime, si dhe një tingull më ekspresiv.

Tani duhet të synojmë në kriteret për të realizuar tipe të ndryshme ushtrimesh, si legatura dhe detashe në zona të ndryshme të harkut.

Në saj të zhvillimit tekniko-muzikor, nxënësi duhet të jetë më i përgjegjshëm për lojën që bën, më i lidhur me studimin, duhet aktivizuar në jetën koncertale si dhe duhet të dëgjojnë njeri-tjetrin.

Tani repertori në tërësi duhet të luhet akoma me kërkesat e një tingulli më të plotë, me një agjilitet gishtash me kërkesë të avancuar tekniko-muzikale.

Nxënësi duhet të fitojë patjetër lëvizshmëri normale dhe të lirshme në tastierë, disa kolpe të harkut, lloje legaturash, tingull të shëndoshë dhe vibrato të vazhdueshme, gjithashtu dhe rritja e cilësisë së tingullit në ushtrimet dy zanore.

Nxënësi duhet të luajë një program të zgjeruar, duke filluar që nga shkallët në tërësi dhe të përforcojë cilësisht ushtrimet në kontrollet teknike.

Të ketë program më të plotë si: sonatë, koncert apo pjesë në formën e bravurave. Mësuesi jo me të gjithë ka të njëjtin rezultat.

### **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

### **Niveli MJAFTUESHËM**

#### **Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- kujdeset për një impostim sa më të drejtë në instrument;
- kontrollon intonacionin;
- deshifron saktë figurat ritmike;
- luan pjesët e përcaktuara sipas programit shkollor.

### **Niveli MIRË**

#### **Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njeh mirë pozicionin dhe luan saktë nga ana intonative;
- luan me një tingull të gjerë e të plotë;
- përvetëson mësimet e vibratos në mënyrë sa më të lirshme dhe natyrale;
- realizon një lojë me vetëkontroll;
- realizon axhilitetin e dorës së majtë.

### **Niveli SHUMË MIRË**

#### **Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan me tingull më të shëndetshme dhe vibrato të vazhdueshme;
- rrit autoritetin gjatë lojës në instrument;
- njeh mirë zonat e harkut dhe legaturen;
- luan me përdorimin e pulsit;

- zgjeron njohuritë për mënyrat e përdorimit të harkut;
- përfshin pozicionet në materialet teknike dhe muzikore e në tastierën e instrumentit të Kontrabasit;
- përvetëson këto pozicione sa më natyrshëm nga;
- impostohet për problemet e avancuara;
- përvetëson kalimet, vazhdimi i punës për përvetësimin e pozicioneve të dorës së majtë në tastierën e instrumentit të Kontrabasit.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Kontrabas, Lexhio, Metronom, Partiture, Internet.

**Dega: MUZIKË**

**Lënda: Oboe**

**Klasa: 6-9**

Tematikat klasa 6	Rezultatet e të nxënit
<p><b>Shkallët muzikore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkallë një oktavëshe me arpezhe përkatëse</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njihet me pjesët përbërëse të instrumentit;</li> <li>- imposton frymëmarrjen me diafragmën;</li> <li>- imposton bokaturën;</li> <li>- mëson të prodhoj tingull;</li> <li>- njihet me tastierën e instrumentit;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- imposton duart;</li> <li>- luan shkallën shumë ngadalë.</li> </ul>
<b>Ushtrime</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hinke - ushtrime fillestare</li> <li>- Barret - metodë për oboe</li> <li>- R.Scozzi - ushtrime fillestare</li> <li>- V.Shiroka - metoda 1 – 2</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan me një tingull të pastër;</li> <li>- luan ritmikiisht saktë;</li> <li>- realizon një frymëmarrje të lirshme;</li> <li>- realizon mirë frakturat ritmike.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ç.Zadeja</li> <li>- T.Harapi</li> <li>- Moxart</li> <li>- Hajden</li> <li>- Breeze easy - pjesë për oboe kapitulli i parë</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njih kompozitorët që kanë shkruar pjesët;</li> <li>- luan pjesën muzikore saktë në ritëm dhe intonacion.</li> </ul>
<b>Tematikat klasa 7</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>Shkallët muzikore</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkallë një oktavëshe ( deri në tri shenja në armaturë, maxhore dhe minore ) me arpezhe përkatëse, terca, triola dhe D7</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan shkallën në ritëm mesatar;</li> <li>- luan me një tingull të pastër;</li> <li>- luan ritmikiisht saktë;</li> <li>- realizon një frymëmarrje të lirshme;</li> </ul>

	- realizon mirë frakturat ritmike.
<b>Ushtrime</b> - Metoda Hinke – kapitulli i tonaliteteve - Barret - metodë për oboe - R.Scozzi - ushtrime - V.Shiroka - metoda 1 – 2	<b>Nxënësi:</b> - përvetëson elementet teknike të lojës në instrument; - luan në instrument me tingull të plotë e intonacion të saktë.
- T.Harapi - Moxart - Brams - Th.Bayley - Breeze easy - pjesë për oboe kapitulli i dytë	<b>Nxënësi:</b> - njeh kompozitorët që kanë shkruar pjesët; - luan pjesën muzikore saktë në ritëm dhe intonacion; - përdor nuancat interpretative; - imposton në mënyrë të sigurtë goditjen legato.
<b>Tematikat klasa 8</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>Shkallët muzikore</b> - Shkallë një oktavëshe ( deri në katër shenja në armaturë, maxhore dhe minore ) me arpezhe përkatëse, terca, triola dhe D7	<b>Nxënësi:</b> - luan shkallën në ritëm dhe realizon mirë frakturat ritmike; - luan me një tingull të pastër dhe ritmikiisht saktë; - realizon një frymëmarrje të lirshme; - përdor nuancat interpretative, në pjesët e repertorit artistik dhe në

	shkallët dhe etydet teknike.
<b>Ushtrime</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Metoda Hinke – kapitulli i tonaliteteve</li> <li>- Barret - metodë për oboe</li> <li>- R.Scozzi - ushtrime</li> <li>- V.Shiroka - metoda 1 – 2</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përvetëson elementet teknike të lojës në instrument;</li> <li>- luan në instrument me tingull të plotë e intonacion të saktë;</li> <li>- përdor nuancat interpretative, në pjesët e repertorit artistik dhe në shkallët dhe etydet.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ç.Zadeja</li> <li>- Moxart</li> <li>- S.Çefa</li> <li>- L.Dizdari</li> <li>- Breeze easy - pjesë për oboe kapitulli i tretë</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- imposton në mënyrë të sigurtë goditjen legato, portato, detashe;</li> <li>- luan pjesën muzikore saktë në ritëm dhe intonacion;</li> <li>- përdor nuancat interpretative;</li> <li>- harmonizon lojën e tij me atë të instrumentit shoqërues të pianos.</li> </ul>
<b>Tematikat klasa 9</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>Shkallët muzikore</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkallë një oktavëshe ( deri në pesë shenja në armaturë, maxhore dhe minore )</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan shkallën në ritëm dhe realizon mirë frakturat ritmike;</li> <li>- luan me një tingull të pastër dhe ritmikiisht saktë;</li> <li>- realizon një frymëmarrje të lirshme;</li> <li>- përdor nuancat interpretative, jo vetëm në pjesët e repertorit artistik, por edhe në shkallët dhe etydet teknike;</li> </ul>



<p><b>Ushtrime</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Metoda Hinke – kapitulli i tonaliteteve</li> <li>- V.Shiroka - metoda 1 – 2</li> <li>- Videman - ushtrime</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përvetëson elementet teknike të lojës në instrument;</li> <li>- luan në instrument me tingull të plotë e intonacion të saktë;</li> <li>- përdor nuancat interpretative në pjesët e repertorit artistik dhe në shkallët dhe etydet.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- F.Ibrahimi</li> <li>- Ç.Zadeja</li> <li>- L.Dizdari</li> <li>- N.Zoraqi</li> <li>- Moxart</li> <li>- G.P.Teleman</li> <li>- Preludio &amp; Gavotta – Corelli</li> <li>- Serenada – F.Delivs</li> <li>- Air – R.Revell</li> <li>- March – J.B.Boismartier</li> <li>- Le fanfaron – E.P.Chedeville</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- imposton në mënyrë të sigurt goditjen legato, portato, detashe;</li> <li>- luan pjesën muzikore saktë në ritëm dhe intonacion;</li> <li>- përdor nuancat interpretative;</li> <li>- harmonizon lojën e tij me atë të instrumentit shoqërues të pianos;</li> <li>- fiton njohuri të mira për regjistrat e instrumentit dhe pozicionet bazë të tij;</li> <li>- zotëron dinamikën (pp, p, mf, f e ff etj.), duke e bërë atë funksionale në të gjitha lidhjet e mundshme të ritmit, tempit, metrit, koloristikës etj.</li> </ul>
<p><b>UDHËZIME METODOLOGJIKE</b></p> <p>Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigoroze. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik dhe emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur</p>	

administrimin psiko emocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënësve e rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do ta bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin. Në lidhje me zbatimin praktik të programit, do të ishte i nevojshëm ndërgjegjësimi i nxënësit me kuptimin e tij, rëndësinë që ka secila pjesë, në formimin sistematik të nxënësit dhe mundësitë që krijojnë ato për avancimin e tij gradual. Kështu, ushtrimet, etydet dhe pjesët e tjera artistike të programit duhet t'u përgjigjen grup moshave të ndryshme, nga ana tjetër, t'u japin mundësi individëve më të përparuar të ecin lirshëm e pa sforcime. Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonte nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt e, së fundi, trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partitura. Sipas kësaj dinamike, kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen. Puna e diferencuar mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecurisë së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij/saj lidhur me programin, në individë që e përvetësojnë atë më shpejt.

Në repertorin muzikor përfshihen pjesë të huaja dhe shqiptare. Ato mund të jenë: romanca, sonata dhe koncerte. Përmes luajtjes së tyre duhet të nxirren në pah karakteristikat kryesore tekniko- muzikore. Për sa i përket anës së muzikalitetit, mësuesi duhet të demonstrojë në instrument teknikat e interpretimit, idetë dhe emocionet e veprës gjithmonë duke u bashkëngjitur dhe shpjegimin e karakteristikave për periudhat, në të cilat janë shkruar veprat muzikore. Me mbylljen e këtij cikli mësimor disavjeçar, nxënësi ka marrë bazat kryesore të formimit muzikor dhe atij instrumental të oboes. Materialet e lëndës së oboes janë bazuar mbi përzgjedhjen e elementeve teknike dhe muzikore.

**Disa nga metodat janë:**

- metoda **1 - 2 dhe 3 - 4**, të cilat janë një përmbledhje bazë e teknikave të ekzekutimit në këtë instrument;
  - metoda **Hinke**;
  - metoda Videman;
- metoda Salviani.

### **Udhëzime Për Vlerësimin:**

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë. Mbi bazën e 3 notave, 2 kontrolleve teknike dhe 1 saxho, vendoset nota semestrale.

### **Niveli MJAFTUESHËM**

#### **Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- mban trupin drejt dhe impostohet saktë në instrument;
- imposton drejt bokaturën;
- merr frymë me diafragmë dhe përvetëson teknikën e frymëmarrjes;
- prodhon tingull;
- imposton bukur dorën e majtë dhe të djathtë;
- luan me duar të impostuara mirë dhe me tingull të pastër;
- luan me ritëm, legatura të thjeshta dhe me intonacion të pastër;
- luan një lojë me kërkesa ritmike dhe me intonacion të pastër;
- përvetëson saktë dhe lirshëm materialin teknik dhe muzikor.

### **Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- realizon një lojë të gjallë, dinamike, me nuancë, duke u futur në stilin, brendinë dhe në karakteristikat e veçanta që ka vepra;
- sinkronizohet me pianistin shoqërues në raportin sonor që kërkohet;
- fiton një siguri dhe një lirshmëri natyrore në lojë;
- njeh veprat në tërësinë e saj, epokat muzikore, kërkesat ndaj rrymave të ndryshme të muzikës.

**Niveli SHUMË MIRË****Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- realizon kërkesat e avancuara tekniko – muzikore si dhe një axhilitet të mirë;
- përvetëson elementet teknike dhe të ketë një pozicion normal të duarve;
- realizon kalimin e pozicioneve, mënyrën e rregullt të lojës së shkallëve (lojën me kërkesë impostimi dhe intonacioni të tercave, triolave, arpezheve dhe D7);
- reagon në ndjeshmërinë muzikore, nuancat, muzikalitetin dhe të paraqitet në sasinë dhe në radhitjen e gjithë repertorit të detyrueshëm, si pjesë, romanca, sonata;
- angazhohet në jetën koncertale;
- formon një shije të tij muzikore, dhe logjikon më shumë ndaj elementeve tekniko-muzikore që karakterizojnë një vepër;
- interpreton etydet dhe pjesët në tempet reale duke zhvilluar aftësitë krijues brenda kërkesave teknike artistike;
- zotëron dinamikën (pp, p, mf, f e ff etj.), duke e bërë atë funksionale në të gjitha lidhjet e mundshme të ritmit, tempit, metrit, koloristikës etj.
- Harmonizon lojën e tij me atë të instrumentit shoqërues të pianos.

Shënim. Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Instrumenti Oboes, Lexhio, Partiturë, Metronom, Sistem audio-video TIK, Interneti.

**Dega: MUZIKË**

**Lënda: Klarinetë**

**Klasa: 6-9**

Tematikat klasa 6	Rezultatet e të nxënit
<ul style="list-style-type: none"><li>- 4 shkallë muzikore dhe materiale ndihmëse teknike</li><li>- Shkallë deri në 2-3 shenja # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar</li><li>- Shkallët deri në 2-3 shenja b (Bemol) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në një Oktavë</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën);</li><li>- praktikon frymëmarrjen dhe frymën nxjerrjen e rregullt (diafragmën);</li><li>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat;</li><li>- përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit;</li><li>- përvetëson pozicionet në oktavën e parë;</li><li>- luan shkallët e arpezhet, intervalet me ritëm të ngadaltë e mesatar:</li><li>- legato e stakato;</li><li>- luan ushtrime gishtash;</li></ul>

<p><b>Ushtrime</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 ushtrime në muaj</li> <li>- Metoda Demnitz, Lefevre</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- luan saktë aplikaturat;</li> <li>- përvetëson elementet teknike si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;</li> <li>- respekton aplikuarat dhe dinamikën;</li> <li>- interpreton me kualitet timbrik intonativ;</li> <li>- zhvillon ushtrime për diafragmën;</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi Artistik</li> <li>- P.Gaci: Nina Nana</li> <li>- Mozart: Pjesë për klarinetë</li> <li>- R.Shuman: Pjesë për klarinetë</li> <li>- Bethoven: Melodi</li> <li>- P.Gaci: Valle për klarinetë</li> <li>- L.Dizdari: Fjalët e qiririt</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-</li> <li>- realizon tempet e pjesëve muzikore;</li> <li>- njeh figurat ritmike;</li> <li>- ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi;</li> <li>- realizon lojën me ngjyra dhe emocionalitet;</li> <li>- praktikon mësimin e pjesëve përmendsh;</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>-</li> <li>- Duete, trio dhe kuartete për klarinetë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;</li> <li>- përvetëson pjesët në klasë;</li> <li>- punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik.</li> </ul>
<p><b>Tematikat klasa 7</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p>
<p><b>Shkallët muzikore</b></p>	<p><b><i>Nxënësi:</i></b></p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të gjitha shkallët me 4 shenja:</li> <li>- me diezis e bemola</li> <li>- minoret përkatëse</li> <li>- arpezhet e tyre, në mënyrat stakato e legato me temp mesatar dhe të shpejtë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- luan shkallët në mënyrë të saktë, pastër e përmendsh, duke prekur gjithë tastierën e flautit;</li> <li>- luan përmbysjet si: kuartola, triola e septola me legato e stakato;</li> <li>- realizon shkallët dhe arpezhet në ritëm dhe temp.</li> </ul>
<p><b>Ushtrime</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 ushtrime në muaj</li> <li>- Metoda Demnitz, Lefevre</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbaton saktë aplikaturat;</li> <li>- interpreton nuancat shprehëse;</li> <li>- respekton dinamikën e ushtrimeve dhe etydeve;</li> <li>- interpreton pastër regjistrat në instrument;</li> <li>- realizon ushtrimet nga ana teknike dhe frazimet muzikore.</li> </ul>
<p>Programi <b>artistik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mozart: Valle Fshatare</li> <li>- L.Bassi: Lamento</li> <li>- Vanhal: Sonatë</li> <li>- N.Kacaruhu: Pjesë për klarinetë</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan pjesët për klarinetë e piano, duke krijuar një harmonizim të plotë të dy instrumenteve;</li> <li>- luan nga ana ritmike e melodike dhe shpreh natyrën koncertale të lojës në instrument;</li> <li>- praktikon mësimin e pjesëve përmendsh; e tingëllimit timbrik, tejshkueshmëria, vibrimi dhe ngjyrat e interpretimit;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Duete, trio e kuartete për klarinetë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;</li> <li>- përvetëson pjesët në klasë;</li> <li>- punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik.</li> </ul>
<b>Tematikat klasa 8</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<p><b>Shkallët muzikore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkallët maxhore e minore me katër shenja me # (Diezis) dhe b (Bemola) me (dy oktava) në ritëm mesatar dhe të shpejtë</li> <li>- Shkallë kromatike në metrin 2/4 e 1/4 në tempe mesatare</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan pastër dhe pa gabime shkallët deri në regjistrat e lartë;</li> <li>- luan përmbysjet e arpezhit dhe D7;</li> <li>- realizon teknikisht dhe muzikalisht ushtrimet;</li> <li>- ndjen frazimet;</li> <li>- luan në tempin e duhur;</li> <li>- luan me një tingull të qartë dhe brilant.</li> </ul>
<p><b>Ushtrime</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ushtrime, etyde dhe materiale ndihmëse teknike</li> <li>- Metoda – Demnitz, Barman, Klose, Rose</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan në stilet dhe tempet e duhura;</li> <li>- realizon duke nxjerrë në pah karakterin e çdo ushtrimi, etydi;</li> <li>- luan bukur emocionalisht dhe në mënyrë virtuoze.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi Artistik</li> <li>- L.Dizdari: Romance</li> <li>- Mozart: Divertimento Nr.3</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon tempet e kohëve të koncertet;</li> </ul>



<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lefevre: Sonata Nr.3</li> <li>- C.M Weber: Variacione</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- njih ndërtimin dhe tempet e variacioneve tek temat me variacione;</li> <li>- ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi;</li> <li>- realizon kërkesat tekniko- muzikore përmes frazimit, karakterit teknik dhe zbërthimit emocional;</li> <li>- luan në stilin e duhur;</li> <li>- luan bukur emocionalisht dhe me dinamikën e duhur.</li> </ul>
<b>Tematikat klasa 9</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<p><b>Shkallët muzikore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkallë një oktavëshe ( deri në pesë shenja në armaturë, maxhore dhe minore )</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan shkallën në ritëm dhe realizon mirë frakturat ritmike;</li> <li>- luan me një tingull të pastër dhe ritmikiisht saktë;</li> <li>- realizon një frymëmarrje të lirshme;</li> <li>- përdor nuancat interpretative, jo vetëm në pjesët e repertorit artistik; por edhe në shkallët dhe etydet teknike;</li> </ul>
<p><b>Ushtrime</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Metoda Hinke – kapitulli i tonaliteteve</li> <li>- V.Shiroka - metoda 1 – 2</li> <li>- Videman - ushtrime</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përvetëson elementet teknike të lojës në instrument;</li> <li>- luan në instrument me tingull të plotë e intonacion të saktë;</li> <li>- përdor nuancat interpretative, jo vetëm në pjesët e repertorit artistik, por edhe në shkallët dhe etydet;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- F.Ibrahimi</li> <li>- Ç.Zadeja</li> <li>- L.Dizdari</li> <li>- N.Zoraqi</li> <li>- Moxart</li> <li>- G.P.Teleman</li> <li>- Preludio &amp; Gavotta – Corelli</li> <li>- Serenada – F.Delivs</li> <li>- Air – R.Revell</li> <li>- March – J.B.Boismartier</li> <li>- Le fanfaron – E.P.Chedeville</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- imposton në mënyrë të sigurt goditjen legato, portato, detashe;</li> <li>- luan pjesën muzikore saktë në ritëm dhe intonacion;</li> <li>- përdor nuancat interpretative;</li> <li>- harmonizon lojën e tij me atë të instrumentit shoqërues të pianos;</li> <li>- fiton njohuri të mira për regjistrat e instrumentit dhe pozicionet bazë të tij;</li> <li>- zotëron dinamikën (pp, p, mf, f e ff etj.), duke e bërë atë funksionale në të gjitha lidhjet e mundshme të ritmit, tempit, metrit, koloristikës etj.</li> </ul>
--	---

### **UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigoroze. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik dhe emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psikoemocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënit e rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do të bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin. Në lidhje me zbatimin praktik të programit, do të ishte i nevojshëm ndërgjegjësimi i nxënësit me kuptimin e tij, rëndësinë që ka secila pjesë në formimin sistematik të nxënësit dhe mundësitë që krijojnë ato për avancimin e tij gradual. Kështu, ushtrimet, etydet dhe pjesët e tjera artistike të programit duhet t’u përgjigjen grupmoshave të ndryshme duke u dhënë mundësi individëve më të përparuar të ecin lirshëm e pa sforcime. Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma

të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit, duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt, e së fundi, trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partitura. Sipas kësaj dinamike, kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen. Puna e diferencuar mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecures së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij/saj lidhur me programin, në individë që e përvetësojnë atë më shpejt.

Në repertorin muzikor përfshihen pjesë të huaja dhe shqiptare. Ato mund të jenë: romanca, sonata dhe koncerte. Përmes luajtjes së tyre duhet të nxirren në pah karakteristikat kryesore tekniko- muzikore. Për sa i përket anës së muzikalitetit, mësuesi duhet të demonstrojë në instrument teknikat e interpretimit, idetë dhe emocionet e veprës gjithmonë duke u bashkëngjitur dhe shpjegimin e karakteristikave për periudhat, në të cilat janë shkruar veprat muzikore. Në mbylljen të këtij cikli mësimor disavjeçar, nxënësi ka marrë bazat kryesore të formimit muzikor dhe atij instrumental të oboes. Materialet e lëndës së oboes janë bazuar mbi përzgjedhjen e elementeve teknike dhe muzikore.

#### **Disa nga metodat janë:**

- metoda **1 - 2 dhe 3 - 4**, të cilat janë një përmbledhje bazë e teknikave të ekzekutimit në këtë instrument;
- metoda **Hinke**;
- metoda Videman;
- metoda Salviani.

#### **Udhëzime Për Vlerësimin:**

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i

lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrrejë një notë. Mbi bazën e 3 notave, 2 kontrolleve teknike dhe 1 saxho, vendoset nota semestrale.

### **Niveli MJAFTUESHËM**

#### **Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- mban trupin drejt dhe impostohet saktë në instrument;
- imposton drejt bokaturën;
- merr frymë me diafragmë dhe përvetëson teknikën e frymëmarrjes;
- prodhon tingull;
- imposton bukur dorën e majtë dhe të djathtë;
- luan me duar të impostuara mirë dhe me tingull të pastër;
- luan me ritëm, legatura të thjeshta dhe me intonacion të pastër;
- luan një lojë me kërkesa ritmike dhe me intonacion të pastër;
- përvetëson saktë dhe lirshëm materialin teknik dhe muzikor.

### **Niveli MIRË**

#### **Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- realizon një lojë të gjallë, dinamike, me nuancë, duke u futur në stilin, brendinë dhe në karakteristikat e veçanta që ka vepra;
- sinkronizohet me pianistin shoqërues në raportin sonor që kërkohet;
- fiton një siguri dhe një lirshmëri natyrore në lojë;
- njeh veprat në tërësinë e saj, epokat muzikore, kërkesat ndaj rrymave të ndryshme të muzikës.

### **Niveli SHUMË MIRË**

### **Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- realizon kërkesat e avancuara tekniko – muzikore si dhe një axhilitet të mirë;
- përvetëson elementet teknike dhe të ketë një pozicion normal të duarve;
- realizon kalimin e pozicioneve, mënyrën e rregullt të lojës së shkallëve (lojën me kërkesë impostimi dhe intonacioni të tercave, triolave, arpezheve dhe D7);
- reagon në ndjeshmërinë muzikore, nuancat, muzikalitetin dhe të paraqitet në sasinë dhe në radhitjen e gjithë repertorit të detyrueshëm, si pjesë, romanca, sonata;
- angazhohet në jetën koncertale;
- formon një shije të tij muzikore, logjikon më shumë ndaj elementeve tekniko-muzikore që karakterizon një vepër;
- interpreton etydet dhe pjesët në tempet reale duke zhvilluar aftësitë krijues brenda kërkesave teknike artistike;
- zotëron dinamikën (pp, p, mf, f e ff etj.), duke e bërë atë funksionale në të gjitha lidhjet e mundshme të ritmit, tempit, metrit, koloristikës, etj.;
- harmonizon lojën e tij me atë të instrumentit shoqërues të pianos.

*Shënim.* Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

### **Materiale dhe burime mësimore:**

Instrumenti Oboes, Lexhio, Partiturë, Metronom, Sistem audio-video TIK, Interneti.

**Dega: MUZIKË**

**Lënda: Fizarmonikë**

**Klasa: 6-9**

Tematikat klasa 6	Rezultatet e të nxënit
<p>- Fizarmonika, historiku i saj</p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- njeh historikun e instrumentit të fizarmonikës;</li><li>- pjesët përbërëse të fizarmonikës;</li><li>- kupton përfitim të tingullit.</li></ul>
<p><b>Etyde:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Farfisa</li><li>- Anzaghi</li><li>- Kareco</li><li>- Cerni</li><li>- Caca etj.</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- zhvillon tingullin dhe organizimin e tyre në temp të shpejtë;</li><li>- realizon lëvizjet e kacekut mbi bazën e logjikës teknike e muzikore;</li><li>- luan duke zhvilluar më tej aftësitë interpretative.</li></ul>
<p><b>Vepër shqiptare :</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- A.Kareco</li><li>- G.Avrazi</li><li>- V.Filaj etj.</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- luan saktë teknikisht dhe muzikalisht;</li><li>- luan pjesët në karakterin e duhur;</li><li>- zhvillon më tej aftësitë interpretative individuale.</li></ul>

<p><b>Variete :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rakic</li> <li>- Dimitriev</li> <li>- J.Colombo</li> <li>- A.Astier etj.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillon shprehinë ekzekutive;</li> <li>- luan frazat të qarta;</li> <li>- luan me tingull të plotë;</li> <li>- unifikon duart.</li> </ul>
<p><b>Tematikat klasa 7</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkallë maxhore dhe minore me dy oktava me shoqërim të thjeshtë basi, ose paralel me dy duar.</li> <li>- Arpezhe, akorde me shoqërim të thjeshtë basi.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan shkallët saktë teknikisht;</li> <li>- përdor korrekt kacekun;</li> <li>- zhvillon tingullin</li> <li>- realizon kalimet e gishtave në dorën e djathtë</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Etyde nga metodat: Farfisa,</li> <li>- Anzaghi, Cerni, Fugazza etj.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- unifikon lojën me dy duar;</li> <li>- zhvillon tingullin;</li> <li>- luan me fraza dhe përdor kacekun;</li> <li>- njeh akordet e dorës së majtë.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vepër shqiptare</li> <li>- Valle, muzikë filmash etj.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan duke unifikuuar lojën e dy duarve;</li> </ul>

	- luan vallet në karakterin e tyre.
Variete :Vals, tango, polka etj. Botero, Rodriguez etj. - Vepër për fizarmonikë ose transkriptime nga kompozitorët klasik ose romantik Bethoven, Moxart, Hayden etj.	<b>Nxënësi:</b> - unifikon lojën; - realizon saktë dinamikat e kërkuara; - zhvillon aftësinë interpretative.
<b>Tematikat klasa 8</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
- Shkallë maxhore, minore (në tri forma) paralel me dy duar, në dy oktava - Linja të kundërta në bas - Arpezhe, akorde, përmbysjet e tyre paralel në dy duar	<b>Nxënësi:</b> - luan saktë teknikisht; - përdor korrekt kacekun; - zhvillon tingullin; - Respekton pozicionet e gishtave; - Unifikon të dy duart.
<b>Metodat:</b> - Farfisa - Anzaghi - Heler - Cerni - Caca etj.	<b>Nxënësi:</b> - zhvillon tingullin dhe organizimin e tyre në temp të shpejtë; - realizon lëvizjet e kacekut mbi bazën e logjikës teknike e muzikore; - luan duke zhvilluar më tej aftësitë interpretative.



<p><b>Vepër polifonike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bach</li> <li>- Moxart</li> <li>- Hendel etj.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan në stil polifoninë;</li> <li>- zhvillon shprehinë ekzekutive;</li> <li>- luan frazat të qarta.</li> </ul>
<p><b>Pjesë shqiptare nga kompozitorët:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- A. Krajka</li> <li>- F.Deda</li> <li>- A.Peci</li> <li>- V.Filaj</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan saktë teknikisht dhe muzikalisht;</li> <li>- luan pjesët në karakterin e duhur;</li> <li>- zhvillon më tej aftësitë interpretative individuale.</li> </ul>
<p><b>Klasike ose romantike : (Transkriptime për fizarmonikë etj.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Moxart</li> <li>- Haydn</li> <li>- Clementi</li> <li>- Chopin</li> <li>- Schubert</li> <li>- Frossini</li> <li>- Deiro etj.</li> </ul> <p><b>Variete :</b></p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon saktë teknikisht dhe muzikalisht;</li> <li>- luan me tingull duke realizuar dinamikat e caktuara, akcentet etj.;</li> <li>- interpreton duke nxjerrë në pah aftësitë individuale.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- R.Galliano</li> <li>- A.Piazzolla</li> <li>- J.Colombo</li> <li>- A.Astier etj.</li> </ul>	
<b>Tematikat klasa 9</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<p><b>Shkallë maxhore, minore me diezis e bemola deri në 7 shenja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- paralel në dy duar</li> <li>- me linja të kundërta në bas</li> <li>- me tercë në bas</li> <li>- Arpezhe, akorde, paralel në dy duar</li> </ul>	<p><b><i>Nxënësi:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- unifikon tingullin dhe lojën në dy duar;</li> <li>- përdor korrekt kacekun duke realizuar frymëmarrjet;</li> <li>- artikulon dhe unifikon saktë gishtat në dy duart.</li> </ul>
<p>Etyde nga metodat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Farfisa</li> <li>- Heler</li> <li>- Cerni</li> <li>- Kramer</li> <li>- Fugazza</li> <li>- Rastelli</li> <li>- Rakic</li> <li>- Coviello etj.</li> </ul>	<p><b><i>Nxënësi:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon lëvizjet e kacekut mbi bazën e logjikës teknike e muzikore;</li> <li>- zhvillon tingullin dhe organizimin e tij në temp të shpejtë;</li> <li>- luan duke zhvilluar interpretimin individual.</li> </ul>

<p><b>Vepër polifonike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bach, Hendel, Scarlatti, Mozart, etj.</li> </ul>	<p><b><i>Nxënësi:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillon shprehitë interpretative;</li> <li>- luan veprat në stilin e duhur;</li> <li>- përdor korrekt kacakun për të realizuar frazat.</li> </ul>
<p><b>Pjesë variete :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Valse ( Colombo, Galliano, Astier, Shtrauss , Larcange etj.)</li> <li>- Polka (Frossini, Astier etj.)</li> <li>- Tango (Piazzolla, Rodriguez, Gade etj. )</li> </ul>	<p><b><i>Nxënësi:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon gjatë lojës në instrument të gjitha elementet teknike-muzikale;</li> <li>- luan veprat në stilin e duhur;</li> <li>- evidenton kontrastet, akcentet, temat kryesore etj.;</li> <li>- zbaton ndërrimin e regjistrave të tingullit në momentet e kërkuara;</li> <li>- zhvillon më tej aftësitë interpretative dhe individualitetin e tij artistik.</li> </ul>
<p><b>Klasike ose romantike : (Transkriptime për fizarmonikë etj.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Moxart</li> <li>- Haydn</li> <li>- Clementi</li> <li>- Chopin</li> <li>- Schubert</li> <li>- Frossini</li> </ul>	<p><b><i>Nxënësi:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon lëvizjet e kacakut mbi bazën e logjikës teknike e muzikore;</li> <li>- zhvillon tingullin dhe organizimin e tij në temp të shpejtë;</li> <li>- luan duke zhvilluar interpretimin individual</li> </ul>

- Deiro etj.

### **Udhëzime metodologjike:**

Nxënësit e klasës së 6 janë fillestarë dhe duhet të tregohet një kujdes i veçantë nga mësuesi në impostimin sa më të saktë të duarve. Mësuesi duhet të përzgjedhë një program të përshtatshëm për nxënësin duke patur parasysh mundësitë fizike dhe intelektin e nxënësit për të gjithë ciklin AMU duke përdorur metoda profesionale si : Farfisa, Anzaghi, Kareco, Rakic, Londonov etj. Programi do të ndahet në 2 orë mësimi gjatë javës, në mënyrë që nxënësi të jetë sa më i qartë me shpjegimin dhe të jetë vazhdimisht në proces studimi. Për arritjen e nivelit sa më të lartë, mësuesit dhe nxënësit duhet të kenë të qartë fazën e punës në të cilën kanë hyrë. Ora e mësimit duhet të ketë intensitet, të mos bëhet monotone, po të zgjojë interes te nxënësi. Përzgjedhja e veprave duhet bërë me kujdes sipas përgatitjes, talentit dhe ecurisë së secilit nxënësi. Duhet këmbëngulur në kultivimin e shijeve të sakta të lojës. Pas studimit të ngadaltë, nxënësi duhet nxitur për të luajtur (manovruar) më shpejt me materialet, por gjithnjë pa e tepruar dhe nën kontrollin e mësuesit, me perspektivën drejt vetëkontrollit. Nxënësi duhet të ndërgjegjësohet e të perceptojë me siguri të lartë atë çfarë ai prodhon. Të nxitet për të performuar në skenë.

Gjatë vitit shkollor zhvillohen 4 kontrolle teknike (klasa VI nuk luan dy kontrollet e para dhe klasa IX luan 1 kontroll çdo periudhe). Në klasën e VII dhe të VIII zhvillohen 4 kontrolle teknike 2 kontroll për çdo periudhë. Në çdo kontroll teknik luhen në mënyrë të detyruar: 1 shkallë maxhore minore, me arpezhe , akorde, si dhe 2 etyde. Programi i saxhos duhet përzgjedhur me kujdes me vepra të epokave të ndryshme të përcaktuara për çdo klasë dhe duke ju përshtatur secilit nxënësi për aftësitë teknike dhe interpretuese të tij.

Sasia e veprave të përzgjedhura nga mësuesi të bëhet në varësi të nivelit dhe ecurisë të çdo nxënësi.

### **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

Vlerësimi në saxho bëhet me komision të përbërë nga mësuesit e instrumentit të fizarmonikës.

**Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur interpreton :**

- me ritëm jo korrekt;
- me tingull të dobët;
- me shkallë shpejtësie të ulët;
- nuk respekton partiturën;
- lojë jo të unifikuar mirë;
- impostim problematik.

**Nxënësi arrin nivelin mesatar kur:**

- luan mirë teknikisht dhe muzikalisht;
- frazim të rregullt;
- tingull të plotë;
- unifikim të duarve;
- impostim korrekt;
- artikulum mesatar.

**Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:**

- realizon programin me të gjithë elementet teknike dhe interpretative të një niveli të lartë.

**Materiale dhe burime mësimore: Fizarmonikë, lexhio, partiturë, internet etj.**

**Dega: MUZIKË**

**Lënda: Korno**

**Klasa: 6-9**

<b>Tematikat klasa 6</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Shkallë muzikore:</li><li>- Shkallë deri në 2-3 shenja # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar</li><li>- Shkallët deri në 2-3 shenja b (Bemol) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në një Oktavë</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën);</li><li>- praktikon frymëmarrjen dhe frymën xjerrjen e rregullt (diafragmën);</li><li>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat;</li><li>- përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit;</li><li>- përvetëson pozicionet në oktavën e parë;</li><li>- luan shkallët e arpezhet, intervalet me ritëm të ngadaltë e mesatar: legato e stakato;</li><li>- luan ushtrime gishtash.</li></ul>
<p><b>Ushtrime dhe etyde</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- 2 ushtrime në muaj</li><li>- Metoda Pascal Proust</li><li>- Pjesë të përshtatura nga autorë të ndryshëm</li><li>- Peter Wastall (fillestarë)</li><li>- Wastall metoda 1</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- luan saktë aplikaturat;</li><li>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;</li><li>- respekton aplikaturat dhe dinamikën;</li><li>- interpreton me kualitet timbrik intonativ;</li><li>- zhvillon ushtrime për diafragmën.</li></ul>

- James Ployhar	
- Programi Artistik Korno - Brahms Ninulle - Minuet J.S.Bach - Holy night - Minuet - J. S. Bach	<b><i>Nxënësi:</i></b> - luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës; - përvetëson pjesët në klasë, nga ana ritmike, dhe kohë pas kohe nga ana e lojës melodike dhe interpretative; - punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik; - zbërthen me korrektësi materialin muzikor nga ana ndërtimore, teknike dhe emocionale.
<b>Tematikat klasa 7</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
- Shkallë muzikore - Shkallët maxhore e minore me tri shenja me # (Diezis) dhe b (Bemola) me (dy oktava) ngadalë dhe me ritëm mesatar. - Shkallë kromatike në metrin 2/4 e 1/4 në tempe mesatare.	<b><i>Nxënësi:</i></b> - luan shkallët me tingull të plotë e pa gabime; - luan shkallët detashe në format stakato e legato; - luan pa gabime arpezhet dhe përmbysjet e tyre; - realizon shkallet muzikore në të gjitha mënyrat.
<b>Ushtrime dhe etyde</b> - 2 ushtrime në muaj - Metoda Pascal Proust	<b><i>Nxënësi:</i></b> - realizon gjatë lojës aplikaturat; - respekton frymëmarrjen, ritmikën e ushtrimit etj.;

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesë të përshtatura nga autorë të ndryshëm</li> <li>- Peter Wastall (fillestarë)</li> <li>- Wastall Matoda 1</li> <li>- James Ployhar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- respekton dinamikën e ushtrimeve;</li> <li>- realizon frymëmarrjen mbi bazën e logjikës muzikore dhe teknike;</li> <li>- luan etydet me ndjenjë, pastër e pa gabime;</li> <li>- luan tingull me intonacion të pastër.</li> </ul>
<p><b>Program artistik      Korno:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Brahms Ninulle</li> <li>- Minuet J.S.Bach</li> <li>- Holy night</li> <li>- Minuet - J. S. Bach</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- praktikon duetet, në fillim me mësuesin dhe, në fazë të dytë luan me nxënës të tjerë bashkëmoshatarë;</li> <li>- ushtron ritmin e pjesëve dhe më pas, tërësinë e tyre melodike;</li> <li>- respekton dinamikën e pjesëve;</li> <li>- punon me mënyra të ndryshme vështirësitë teknike që shfaqen në</li> <li>- materialin muzikor;</li> <li>- dallon karakteristikat e autorëve të veçantë.</li> </ul>
<p><b>Tematikat klasa 8</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkallë muzikore</li> <li>- Të gjitha shkallët me 4 shenja</li> <li>- me diezis e bemola</li> <li>- minoret përkatëse</li> <li>- arpezhet e tyre, në mënyrat stakato e legato me temp mesatar dhe të shpejtë</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan shkallët në mënyrë të saktë, pastër e përmendsh, duke prekur gjithë tastierën e flautit;</li> <li>- luan përmbysjet, si: kuartola, triola e septola me legato e stakato;</li> <li>- realizon shkallët dhe arpezhet në rritem dhe temp.</li> </ul>



<ul style="list-style-type: none"> <li>- Metodatat Proust dhe ushtrime të përditshme nga autorë të ndryshëm</li> </ul>	
<p><b>Ushtrime dhe etyde</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 etyde në muaj si më poshtë:</li> <li>- Proust</li> <li>- Koprasch</li> </ul>	<p><b><i>Nxënësi:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbaton sakte aplikaturat;</li> <li>- interpreton nuancat shprehëse;</li> <li>- respekton dinamikën e ushtrimeve dhe etydeve;</li> <li>- interpreton pastër regjistrat ne instrument;</li> <li>- realizon etydet nga ana teknike dhe frazimet muzikore.</li> </ul>
<p><b>Programi artistik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 kohë koncerti</li> <li>- Minuete</li> <li>- Pjesë solo për Korno</li> <li>- Pjesë nga autorë të huaj</li> <li>- Pjesë nga autorë shqiptarë</li> <li>- W. A. Mozart Koncert</li> <li>- W. A. Mozart</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;</li> <li>- luan pjesët për korno e piano, duke krijuar një harmonizim të plotë të dy instrumenteve;</li> <li>- luan nga ana ritmike e melodike dhe shpreh natyrën koncertale të lojës në instrument;</li> <li>- praktikon mësimin e pjesëve përmendsh;</li> <li>- shprehë në mënyrë të konsoliduar elementet e tingëllimit, si: pastërtia timbrike, tejshkueshmëria, vibrimi dhe ngjyrat e interpretimit;</li> <li>- evidenton karakteristikat e autorëve të veçantë të pjesëve;</li> <li>- zbërthen veçoritë e formës muzikore.</li> </ul>
<p><b>Tematikat klasa 9</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkallë muzikore</li> <li>- me diezis e bemola,</li> <li>- minoret përkatëse,</li> <li>- arpezhet e tyre, në mënyrat stakato e legato.</li> <li>- Metodat Koprasch 1, Proust</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan shkallët në mënyrë të saktë, pastër e përmendsh, duke prekur gjithë tastierën e flautit;</li> <li>- luan përmbysjet, si: kuartola, triola e septola me legato e stakato;</li> <li>- ka një organizim të mirë e të qartë të shkallëve e arpezheve.</li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>Ushtrime dhe etyde</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 etyde në muaj si më poshtë:</li> <li>- Prout</li> <li>- Koprasch</li> <li>- Ushtrime të përshtatura nga autorë të ndryshëm</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Luan shkallët në mënyrë të saktë, pastër e përmendsh, duke prekur gjithë tastierën e flautit.</li> <li>- Luan përmbysjet, si: kuartola, triola e septola me legato e stakato.</li> <li>- Ka një organizim të mirë e të qartë të shkallëve e arpezheve.</li> </ul>
<p><b>Programi artistik Korno</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 kohë koncert</li> <li>- Minuete</li> <li>- Suita</li> <li>- Pjesë nga autorë të huaj</li> <li>- Pjesë nga autorë shqiptarë</li> <li>- J.S. Bach: Menuet</li> <li>- W. A. Mozart: Rondo</li> <li>- W. A. Mozart: Koncert Nr. 1</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;</li> <li>- luan pjesët për flaut e piano, duke krijuar një harmonizim të plotë të dy instrumenteve;</li> <li>- luan nga ana ritmike e melodike dhe shpreh natyrën koncertale të lojës në instrument;</li> <li>- praktikon mësimin e pjesëve përmendsh;</li> <li>- shpreh në mënyrë të konsoliduar elementet e tingëllimit, si: pastërtia timbrike, tejshkueshmëria, vibrimi dhe ngjyrat e interpretimit;</li> </ul>

- W. A. Moxart: Koncert Nr. 3

- evidenton karakteristikat e autorëve të veçantë të pjesëve;
- zbërthen veçoritë e formës muzikore.

### **UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për të arritur një nivel sa më të mirë të lojës në instrument, nxënësi duhet edukuar të studiojë në mënyrë sa më sistematike. Në këtë proces, puna e mësuesit duhet të jetë e vazhdueshme, e thelluar dhe e lidhur ngushtë me vëzhgimin psikologjik e emocional të nxënësit, që nga shkallët e para të formimit, deri në plotësinë e mjaftueshme të tij. Për të pasur rezultate sa më të mira, trajtimi psikoemocional duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit dhe të synojë, në radhë të parë, një administrim sa më të mirë të orës së mësimit. Po ashtu, ndërthurja e kërkesave teknike të lojës në instrument me kërkesat artistike të veprave të veçanta, do t'i jepte orës së mësimit më shumë frymëmarrje dhe do ta bënte atë më të pëlqyeshme për nxënësin.

Në lidhje me zbatimin praktik të programit, do të ishte i nevojshëm ndërgjegjësimi i nxënësit me kuptimin e tij, rëndësinë që ka secila pjesë në formimin sistematik të nxënësit dhe mundësitë që krijojnë ato për avancimin e tij gradual. Kështu, ushtrimet, etydet dhe pjesët e tjera artistike të programit duhet t'u përgjigjen grupmoshave të ndryshme dhe, nga ana tjetër, t'u japin mundësi individëve më të përparuar të ecin lirshëm e pa sforcime.

Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, edhe kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt e, së fundi, trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partitura. Sipas kësaj dinamike, edhe kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen.

### **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë. Mbi bazën e **3 notave, 2 kontrolleve teknike dhe 1 saxho**, vendoset nota semestrale.

**Nxënës/i,-ja arrin nivelin e ulët, kur:**

- luan jo korrekt;
- me ritëm;
- me tingull mesatar;
- me intonacion jo të këndshëm;
- me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

**Nxënës/i,-ja arrin nivelin mesatar, kur:**

- luan mirë;
- ritmiksht,;
- me tingull e me intonacion, pastër e me pak gabime.

**Nxënës/i, -ja arrin nivelin e lartë, kur:**

- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.

Shënim: Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Korno, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet.

**Dega: MUZIKË**

**Lënda: Trombë**

**Klasa: 6-9**

Tematikat klasa 6	Rezultatet e të nxënit
<p><b>Shkallë</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Shkallet Do+, Si bemol+ me minoret përkatëse në një oktavë</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën);</li><li>- praktikon frymëmarrjen dhe frymën nxjerrjen e rregullt (diafragmën);</li><li>- përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit;</li><li>- luan shkallët e arpezhet, me ritëm të ngadaltë e mesatar: legato stakato.</li></ul>
<p><b>2-3 Ushtrime në muaj:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Paul Herfurth- Fletorja I-II</li><li>- Veber- Fletorja e parë</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- luan saktë aplikaturat.</li><li>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;</li><li>- respekton aplikaturat dhe dinamikën;</li><li>- interpreton me kualitet timbrik intonativ;</li><li>- zhvillon ushtime për diafragmën.</li></ul>
<p><b>Vepër shqiptare :</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- P. Gaci</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p>

- C. Zadeja	- respekton të gjitha problemet teknike; - interpreton sa më natyrshëm.
<b>Programi Artistik:</b> - Mendelson- Melodi - Bach- Melodi - Persell- Pjesë Muzikore - Mozart- Minuet Presto	<b>Nxënësi:</b> - realizon tempet e pjesëve muzikore; - njih figurat ritmike; - ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi; - realizon lojën me ngjyra dhe emocionalitet; - praktikon mësimin e pjesëve përmendësh.
<b>Tematikat klasa 7</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
- Shkallë Muzikore - Shkallët Fa+, Mi Bemol+ - Me minoret përkatëse në një oktavë	<b>Nxënësi:</b> - luan shkallët me tingull të plotë e pa gabime; - luan shkallët detashe në format stakato e legato; - realizon shkallet muzikore e minore ne te gjitha mënyrat
<b>2-3 Ushtrime në muaj</b> - Voxman- Fletorja I - Rap- Fletorja II - Veber- Fletorja II-III	<b>Nxënësi:</b> - realizon gjatë lojës aplikaturat, frymëmarrjen, ritmikën e ushtrimit etj.; - respekton dinamikën e ushtrimeve;

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon frymëmarrjen mbi bazën e logjikës muzikore dhe teknike;</li> <li>- luan ushtrimet me ndjenjë, pastër e pa gabime;</li> <li>- luan tingull me intonacion të pastër.</li> </ul>
<b>Vepër shqiptare:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- P. Gaci</li> <li>- K. Laro</li> <li>- P. Jakova</li> <li>- C. Zadeja</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- respekton të gjitha problemet teknike;</li> <li>- evidenton të gjitha karakteristikat kryesore dhe ndërtimin e saktë të pjesëve.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesë të Huaja:</li> <li>- Persell- Pjesë Muzikore</li> <li>- Humel- Romancë</li> <li>- Hendel- Minuet</li> <li>- Anon- Pjesë Muzikore</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njih formën dhe ndërtimin të veprës që luan;</li> <li>- njih mirë stilin e autorit;</li> <li>- dallon tempet e ndryshme brenda veprës;</li> <li>- luan me rrjedhshmëri në kalimet;</li> <li>- luan me një tingull qartë dhe i përshtatet lojës dinamike të veprës.</li> </ul> <p>Tabela Tali.</p>
<b>Tematikat klasa 8</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkallë Muzikore</li> <li>- te gjitha shkallët</li> <li>- Maxhore, Minore së bashku me relativet përkatëse në dy oktava</li> </ul>	<b>Nxënësi</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>-</li> <li>- luan shkallët me tingull të plotë e pa gabime;</li> </ul>

- Arpezhet me temp mesatar – të shpejtë	- luan shkallët detashe në format stakato e legato; - realizon shkallët muzikore e minore në të gjitha mënyrat;
<b>3-4 Ushtrime në muaj</b> - Perreti - Voxman- Fletorja I - Koprash 12 etyde - Arban	- realizon gjatë lojës aplikaturat, frymëmarrjen, ritmikën e ushtrimit etj.; - respekton dinamikën e ushtrimeve; - realizon frymëmarrjen mbi bazën e logjikës muzikore dhe teknike; - luan ushtrimet me ndjenjë, pastër e pa gabime; - luan tingull me intonacion të pastër;
<b>Vepër shqiptare</b> - P. Gaci - C. Zadeja - A. Grimci - V. Nova	- respekton të gjitha problemet teknike; - evidenton të gjitha karakteristikat kryesore dhe ndërtimin e saktë të pjesëve;
- Pjesë të Huaja: - Humel- Romance - Marcelo- Sonate	- njih formën dhe ndërtimin të veprës që luan; - njih mirë stilin e autorit; - dallon tempet e ndryshme brenda veprës; - luan me rrjedhshmëri në kalimet; - luan me një tingull qartë dhe t’i përshtatet lojës dinamike të veprës.
<b>Tematikat klasa 9</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>



<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkallë Muzikore</li> <li>- të gjitha shkallët</li> <li>- Maxhore, Minore së bashku me relativet përkatëse në dy oktava</li> <li>- Arpezhet me temp mesatar – të shpejtë</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan shkallët me tingull të plotë e pa gabime;</li> <li>- luan shkallët detashe në format stakato e legato;</li> <li>- realizon shkallët muzikore e minore në të gjitha mënyrat;</li> </ul>
<p><b>4 Ushtrime në muaj</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bai Lin- Përkuļja e buzës</li> <li>- Arban- Kapitulli i dopio stakatos</li> <li>- Koprash- Etyde</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- frymëmarrjen, ritmikën e ushtrimit etj.;</li> <li>- respekton dinamikën e ushtrimeve;</li> <li>- realizon frymëmarrjen mbi bazën e logjikës muzikore dhe teknike;</li> <li>- luan ushtrimet me ndjenjë, pastër e pa gabime;</li> <li>- luan tingull me intonacion të pastër;</li> </ul>
<p><b>Vepër shqiptare</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- P. Gaci</li> <li>- C. Zadeja</li> <li>- A. Grimci</li> <li>- V. Nova</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- respekton të gjitha problemet teknike;</li> <li>- evidenton të gjitha karakteristikat kryesore dhe ndërtimin e saktë të pjesëve;</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesë të Huaja:</li> <li>- K. Shaven- Sonatë</li> <li>- Hendel- Sonatë</li> <li>- Humel- Koncert, koha I</li> <li>- Shellakov- Koncertino</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh formën dhe ndërtimin e veprës që luan;</li> <li>- njeh mirë stilin e autorit;</li> <li>- dallon tempet e ndryshme brenda veprës;</li> <li>- luan me rrjedhshmëri në kalimet;</li> <li>- luan me një tingull qartë dhe që i përshtatet lojës dinamike të veprës.</li> </ul>

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

- Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Mësuesi i lëndës, për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, ka të drejtë të ulë ose të ngrrejë një notë.

### Niveli MJAFTUESHËM

#### Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:

- luan jo korrekt
- me ritëm;
- me tingull mesatar;
- me intonacion jo të këndshëm.

### Niveli MIRË

#### Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:

- luan *mirë* ritmikisht;
- me tingull e me intonacion, pastër e me pak gabime.

### Niveli SHUMË MIRË

#### Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

### Materiale dhe burime mësimore:

Tromba, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet.

**Dega: MUZIKË**

**Lënda: Trombon**

**Klasa: 6-9**

Tematikat klasa 6	Rezultatet e të nxënit
<ul style="list-style-type: none"><li>- 4 shkallë muzikore dhe materiale ndihmëse teknike</li><li>- Shkallë deri në 2-3 shenja # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar</li><li>- Shkallët deri në 2-3 shenja b (Bemol) dhe relativet e tyre me rritem të ngadaltë dhe mesatar deri në një Oktavë</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën);</li><li>- praktikon frymëmarrjen dhe frymënxjerrjen e rregullt (diafragmën);</li><li>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart në pozicionin optimal me instrumentin;</li><li>- përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit;</li><li>- përvetëson pozicionet në oktavën e parë;</li><li>- luan shkallët e arpezhet, intervalet me ritëm të ngadaltë e mesatar: legato e stakato.</li></ul>
<p><b>Ushtrime</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- 2 ushtrime në muaj</li><li>- Rubank Elementary</li></ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- luan saktë aplikaturat;</li><li>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;</li><li>- respekton aplikaturat dhe dinamikën;</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- interpreton me kualitet timbrik intonativ;</li> <li>- zhvillon ushtime për diafragmën.</li> </ul>
<b>Programi Artistik</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bourgeois</li> <li>- Edney Endresen</li> <li>- Gregson Hering</li> <li>- Nightingale</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon tempet e pjesëve muzikore;</li> <li>- njih figurat ritmike;</li> <li>- ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi;</li> <li>- realizon lojën me ngjyra dhe emocionalitet.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Duete për Trombon</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan duetet në klasë së bashku me mësuesin ose me shokët e klasës;</li> <li>- përvetëson pjesët në klasë;</li> <li>- punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik.</li> </ul>
<b>Tematikat klasa 7</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>Shkallë muzikore</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkallët maxhore e minore me tri shenja me # (Diezis) dhe b (Bemola) me (dy oktava) ngadalë dhe me ritëm mesatar</li> <li>- Shkallë kromatike në metrin 2/4 e 1/4 në tempe mesatare</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan shkallët me tingull të plotë e pa gabime;</li> <li>luan shkallët detashe në format stakato e legato;</li> <li>- luan pa gabime arpezhet dhe përmbysjet e tyre;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- rrealizon shkallët muzikore e minore në të gjitha mënyrat.</li> </ul>
<p><b>Ushtrime</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 ushtrime në muaj</li> <li>- A. Voxman</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon gjatë lojës aplikaturat, frymëmarrjen, ritmikën e ushtrimit etj.;</li> <li>- respekton dinamikën e ushtrimeve;</li> <li>- realizon frymëmarrjen mbi bazën e llogjikës muzikore dhe teknike;</li> <li>- luan ushtrimet me ndjenjë, pastër e pa gabime;</li> <li>- luan tingull me intonacion të pastër.</li> </ul>
<p><b>Program artistik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gagnebin</li> <li>- Haydn Mozart</li> <li>- Purcell Trad.</li> <li>- WarLOCK</li> <li>- No.6 OR No.9 <i>from</i> Splinters of Bone</li> <li>Mixte Meter OR Tango <i>from</i> Melodic Studies for Trombone, Book 2</li> <li>No.8 OR No.9 <i>from</i> Supplementary Studies for Trombone</li> <li>No.16 OR No.17 <i>from</i> 20 Supplementary Tunes for Beginner Brass</li> <li>- Sarabande</li> <li>Rondino <i>from</i> Slide për Trombon</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njih formën dhe ndërtimin të veprës që luan;</li> <li>- njih mirë stilin e autorit;</li> <li>- dallon tempet e ndryshme brenda veprës;</li> <li>- luan me rrjedhshmëri në kalimet</li> <li>- luan me një tingull qartë dhe t'i përshtatet lojës dinamike të veprës.</li> </ul>

<p>March of the Priests <i>from</i> Slide Show for Trombone  O Isis and Osiris from the Magic Flute, No.2 <i>from</i> A  - Mozart Solo Album  Air <i>from</i> Festive Baroque (arr. Van Beringen)  El Desembre Conglelat from Suite: Creme Catalan <i>from</i> First Book of Trombone Solos</p>	
<p>- Duete, Trombon</p>	<p><b><i>Nxënësi:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;</li> <li>- përvetëson pjesët në klasë;</li> <li>- punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik.</li> </ul>
<p><b>Tematikat klasa 8</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p>
<p><b>Shkallë muzikore</b>  <b><i>Të gjitha shkallët me 4 shenja</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- me diezis e bemola,</li> <li>- minoret përkatëse,</li> <li>- arpezhet e tyre, në mënyrat stakato e legato me temp mesatar dhe të shpejtë</li> </ul>	<p><b><i>Nxënësi:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan shkallët në mënyrë të saktë, pastër e përmendsh, duke prekur gjithë tastierën e flautit;</li> <li>- luan përmbysjet, si: kuartola, triola e septola me legato e stakato;</li> <li>- realizon shkallët dhe arpezhet në rritem dhe temp.</li> </ul>

<p><b>Ushtrime</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 ushtrime në muaj</li> <li>- J. Rochur</li> <li>- G. Concone</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbaton sakte aplikaturat;</li> <li>- interpreton nuancat shprehëse;</li> <li>- respekton dinamikën e ushtrimeve dhe etydeve;</li> <li>- interpreton pastër regjistrat në instrument;</li> <li>- realizon ushtrimet nga ana teknike dhe frazimet muzikore.</li> </ul>
<p><b>Programi artistik</b></p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- interpreton stilin e autorit që do të luajë;</li> <li>- performon bukur, në mënyrë koncertale nga ana teknike artistike.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Duete, trio e kuartete për Trombon</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;</li> <li>- luan pjesët për flaut e piano , duke krijuar një harmonizim të plotë të dy instrumenteve;</li> <li>- punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik.</li> </ul>
<p><b>Tematikat klasa 9</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p>
<p><b>Shkallë muzikore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- me diezis e bemola,</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan shkallët në mënyrë të saktë, pastër e përmendsh, duke prekur</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- minoret përkatëse,</li> <li>- arpezhet e tyre, në mënyrat stakato e legato</li> </ul>	<p>gjithë tastierën e flautit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luanan përmbysjet, si: kuartola, triola e septola me legato e stakato; organizon mirë e qartë shkallët e arpezheve.</li> </ul>
<p><b>Ushtrime</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 ushtrime në muaj</li> <li>- Rubank, Metoda e Përparuar</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- është i përpiktë në zbatimin e aplikaturave;</li> <li>- realizon nuancat shprehëse;</li> <li>- respekton dinamikën e ushtrimeve dhe etydeve;</li> <li>- realizon unifikimin e regjistrave;</li> <li>- zbaton kërkesat për një frymëmarrje të lirshme e të natyrshme.</li> </ul>
<p><b>Programi artistik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- BACH Polonaise nga Bach për Trombone (arr. Mowat) (<i>Brass Wind</i>) BYRD The Earl of Salisbury's Pavane nga Just (<i>Chester / Music Sales</i>)</li> <li>- CHARPENTIER Prelude to Te Deum from Savoir Faire (arr. Mowat)</li> <li>- GALLIARD Menuet alternat, No.3 from Solos for the Trombone Player (arr. Clark) (<i>G Schirmer / Music Sales</i>) HASSE Bourrée from Festive Baroque</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan pjesët për trombon e piano , duke krijuar një harmonizim të plotë të dy instrumenteve</li> <li>- luan nga ana ritmike e melodike dhe shpreh natyrën koncertale të lojës në instrument;</li> <li>- praktikon mësimin e pjesëve përmendësh;e tingëllimit timbrike, tejshkueshmëria, vibrimi dhe ngjyrat e interpretimit.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Duete, trio e kuartete për Trombon</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p>



- luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;
- përvetëson pjesët në klasë;
- punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik.

### Udhëzime metodologjike:

- Nxënësit e klasës së 6 janë fillestarë dhe duhet të tregohet një kujdes i veçantë nga mësuesi në impostimin sa më të saktë të duarve. Mësuesi duhet të ketë parasysh që për një formim sa më të saktë të dorës së djathtë duhet të punojë me arpezhet dhe për këtë arsye këshillohet të punojë me metodën Demnitz e Lefevre.
- Programi do të ndahet në 2 orë mësimi gjatë javës, në mënyrë që nxënësi të jetë sa më i qartë me shpjegimin dhe të jetë vazhdimisht në proces studimi. Nxënësi nuk merr pjesë në dy kontrollet teknike të parë, kjo shërben për ti dhënë më shumë kohë për të krijuar një impostim të saktë të duarve.
- Për nxënësit e klasës së 7-të, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit. Duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale. Nxënësi duhet të njohë figurat ritmike dhe të pickojë qartë telat e kitarës; duhet të njohë pozicionin e parë dhe të dytë të kitarës; duhet të luajë rrjedhshëm shkallët dhe me tingull të lidhur; duhet të njohë zërat në pjesë dhe të interpretojë me shenjat e ngjyrimit, sipas stilit muzikor që luan.

**Nxënësit e klasës së 8-të duhet të luajnë me program që përfshin tri periudhat stilistike si: barok, klasik dhe romantik. Nxënësi: duhet të ketë të qartë zërat në pjesë dhe të interpretojë bukur stilin barrok; duhet të respektojë shenjat e ngjyrimit dhe interpretimin në stilin klasik.**

- Në klasën e 9-të nxënësi nuk luan dy kontrolle teknike, për t'i dhënë kohë në përgatitjen e programit të saxhos dhe atij të konkursit. I caktohet një program individual në varësi të teknikës që zotëron dhe të mundësive interpretuese që ka. Është e këshillueshme që programi të jetë i

përbërë nga një kohë Mozart temë me variacione si dhe një sonatë lefevre.

- Rekomandime për kontrollet teknike
- Gjatë vitit shkollor zhvillohen 4 kontrolle teknike (klasa VI nuk luan dy kontrollet e para dhe klasa IX luan 1 kontroll çdo semestër). Në çdo kontroll teknik luhen në mënyrë të detyruar 2 shkallë (maxhore- minore, terca, oktava) me të gjitha mënyrat, si dhe 2 etyde.
- I gjithë programi luhet përmendësh.
- Rekomandime për saxhot
- Gjatë vitit shkollor zhvillohen 2 saxho.

#### **Udhëzime Për Vlerësimin:**

Vlerësimi i nxënësit në kontrollet teknike do të bëhet në mënyrë kolegjiale nga të gjithë mësuesit që kanë nxënës në klasën përkatëse (me jo më pak se 3 veta).

Vlerësimi do të jetë nga notat e vendosura për materialet që luan nxënësi.

Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Vlerësimi i nxënësit në saxhot do të bëhet në mënyrë kolegjiale nga komisioni i mësuesve të caktuar nga drejtoria (me jo më pak se 3 veta). I përfshirë në vlerësimet e komisionit do të jetë edhe vlerësimi i mësuesit përkatës të nxënësit. Vlerësimet e nxënësve do të diskutohen nga anëtarët e komisionit.

Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe i përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga anëtarët komisionit, plus notën e mësuesit të lëndës.

#### **Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur :**

- ka lëvizje me ritmin;

- ka pickim të dobët dhe tingull mesatar;
- luan me intonacion jo të këndshëm;
- nuk ka qartësi në lojë;
- luan me disa gabime.

**Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:**

- luan mirë ritmikisht;
- luan me tingull e me intonacion;
- luan pastër e me pak gabime.

**Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:**

- luan shumë mirë ritmikisht;
- luan me tingull të qartë dhe të lidhur;
- luan përmendësh dhe pa gabime;

interpretet dhe luan me ndjeshmëri pjesët.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Trombon, Lexhio, Intonator , Metronome

**Dega: Muzikë**

**Lënda Bastuba**

**Klasa: 6-9**

Tematikat klasa 6	Rezultatet e të nxënit
<b>1 -2 shkallë muzikore, ushtrime dhe materiale ndihmëse teknike</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- ka impostim të mirë të instrumentit dhe posturës;</li><li>- realizon teknikisht shkallët maxhore dhe minore;</li><li>- realizon të gjitha mënyrat e dorës së djathtë, dhe respekton gishtat e dorës së majtë në metodat përkatëse;</li><li>- realizon teknikisht ushtrimet;</li><li>- luan në tempin e duhur;</li><li>- zotëron regjistrin e ulët, të mesëm në një regjistër oktavë;</li><li>- zhvillon barazinë e zërit dhe timbrin regjistrin e një oktavë përmes ekzekutimit të shkallëve deri në një ndryshim në tonalitetin madhor dhe mënyrat e tyre përkatëse të vogla - F Major/D Minor ose G Major/E Minor;</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Pjesë të Huaja</li><li>- Camille Saint-Saens-Mjellma; Allen</li><li>- Ostrander-Kënga e Lehës; Gordon Jacob -</li><li>- Gjashtë pjesë të vogla Tuba; Gordon Jacob-</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- realizon tempet e pjesëve muzikore;</li><li>- njeh figurat ritmike;</li><li>- ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi.</li></ul>

- Kënga e Mjellmës.	
Tematikat klasa 7	Rezultatet e të nxënit
<b>4 - shkallë muzikore, etyde dhe materiale ndihmëse teknike <i>legato dhe staccato</i></b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan shkallët dhe me tingull të qartë;</li> <li>- realizon ushtrimet teknike për të përvetësuar teknikën e legatës;</li> <li>- kryen frymëmarrje të mirë dhe të kontrolluar;</li> <li>- zotëron vendosjen e mirë të bukaturës;</li> <li>- zotëron regjistrin e ulët, të mesëm në një regjistër oktavë;</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ushtrime, materiale Teknike</li> <li>- JB Arban-Libri i Parë; Roger Bobo-</li> <li>- Zotërimi i Tubës;</li> <li>- Rruga A-Shakllë &amp; Arpezhet; Walter</li> <li>- Hilgres-Rutina e perditshme; David</li> <li>- Uber-Studimet e Hershme; RH Fink-</li> <li>- Studime në Legato</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- kryen frymëmarrje të mirë dhe të kontrolluar;</li> <li>- zotëron vendosjen e mirë të ambukurës;</li> <li>- zotëron regjistrin e mesit të ulët dhe të mesit të lartë në një regjistër oktavë e gjysmë;</li> <li>- zhvillon barazinë e zërit dhe timbralit në regjistrin e një oktavë, nëpërmjet ekzekutimit të shkallëve;</li> <li>- luan deri në dy ndryshime në çelësin madhor dhe në modalitetet e tyre përkatëse të vogla - Bb Major/G Minor ose D Major/Bb Minor dhe arpezhet e tyre përkatëse në gjendjen themelore ose deri në përmbysjen e parë;</li> <li>- luan dy shkallët kromatike të Bb dhe D Major me artikulacione të ndryshme: legato dhe staccato;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- kryen ushtrimet me figurat ritmike në nota gjysmë, çerek dhe nota të 3/8teta me shpejtësi minimale të notave me temp të barabartë me 60/80;</li> <li>- zotëron gishtat e përdorur për të kryer të njëjtat ushtrime ;</li> <li>- përvetëson njohuri dhe teknika që ju lejojnë të përdorni dinamikën e mëposhtme: piano dhe i fortë;</li> <li>- përvetëson një artikulum të qartë dhe të pastër – ushtrimeve;</li> <li>- luan shkallët në të gjitha masat e thjeshta: 4/4; 3/4; 2/4; 11;</li> <li>- fiton fleksibilitet të mirë në pjesët harmonike 1, 2, 3 dhe 5.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 Bravura</li> <li>- William Presser -Rondo; Gordon Jacob -</li> <li>- Bagatelle për Tuba; Art Dedrick -Zoti Tuba në ;</li> <li>- Broadway; R. Wagner (arr. George Masso)</li> <li>- Walter Edward Elgar -Dy Këngë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh formën dhe ndërtimin të veprës që luan;</li> <li>- njeh mirë stilin e autorit;</li> <li>- dallon tempet e ndryshme brenda veprës;</li> <li>- luan me rrjedhshmëri në kalimet;</li> <li>- luan me një tingull qartë dhe t'i përshtatet lojës dinamike të veprës.</li> </ul>
<b>Tematikat klasa 8</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 shkallë muzikore, etyde dhe materiale ndihmëse teknike , maxhore, minore, me intervale terca dhe quartta</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan të gjitha materialet ndihmëse në funksion të shkallës së vështirësisë që ka programi;</li> <li>- njeh tri pozicionet e para të kitarës;</li> <li>- pickon qartë mbi tela dhe ka rrjedhshmëri në arpezhet;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon teknikisht etydet;</li> <li>- luan në ritmet dhe tempet e duhura;</li> <li>- luan me kontrastet dinamike;</li> <li>- kryen frymëmarrje të mirë dhe të kontrolluar;</li> <li>- zotëron regjistrin e mesit të ulët, regjistrin e mesit të lartë në një oktavë e gjysmë dhe, në varësi të shkallës, mund të shkojë deri në dy oktava të plota A Major/F mprehtë e vogël;</li> <li>- zhvillon barazinë e zërit dhe timbralit në regjistrin e një oktavë, përmes ekzekutimit të shkallëve deri në tre ndryshime në çelësin kryesor dhe në modalitetet e tyre përkatëse të vogla - Eb Major/C Minor ose A Major/F Sharp Minor dhe arpezhet e tyre përkatëse në gjendjen themelore ose deri në përmbysjen e parë.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Etyde</li> <li>- William Bell -Metoda e plotë Tuba e William J. Bell; Giulio Marco</li> <li>- Bordogni –Studime Bordogni; Sam Palfian, Patrick Sheridan -</li> <li>- Palestrën e frymëmarrjes; Giuseppe Concone – Vëllimi 1; -</li> <li>- JB Arban –Metoda e plotë për Tuba;</li> <li>- C. Kopprasch –60 Studime të zgjedhura; Jacob</li> <li>- Wesley -Studime me regjistër të ulët; Gilles</li> <li>- Millière -Ushtrime në dy oktava</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- interpreton stilin e autorit që do të luajë;</li> <li>- performon bukur, në mënyrë koncertale nga ana teknike artistike.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 Bravura</li> <li>- Harold Walters -Blow the Man Down;</li> <li>- Michel del Giudice –Abuto; Pierre Seguin –</li> <li>- Tubavardage; Art Dedrick -A Touch of Tuba;</li> <li>- Rodger Vaughan -Concert Piece; Walter</li> <li>- Skolnik -Valse Caprice.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh epokat dhe stilet e autorëve që do të luajë;</li> <li>- luan me tingull të lidhur dhe me pak rubato;</li> <li>- performon bukur me të gjitha elementet tekniko-profesionale;</li> <li>- transmeton emocione;</li> <li>- ndjen individualitetin e tij në lojë.</li> </ul>
<p><b>Tematikat klasa 9</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 shkallë muzikore, etyde dhe materiale ndihmëse teknike, intervalet ( Seconda, Terca, Quarta ecc. )</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- luan të gjitha materialet ndihmëse në funksion të shkallës së vështirësisë që ka programi;</li> <li>- realizon teknikisht etydet;</li> <li>- luan në ritmet dhe tempet e duhura;</li> <li>- luan me kontrastet dinamike;</li> <li>- zotëron regjistrin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në një regjistër me dy oktavë;</li> <li>- zhvillon barazinë e zërit dhe timbrit në regjistrin e dy oktavave, nëpërmjet ekzekutimit të shkallëve;</li> <li>- ekzekuton deri në katër dhe pesë ndryshime në tonalitetin madhor dhe modalitetet e tij të vogla përkatëse; E Major/C Sharp Minor ose</li> </ul>



	<p>A B Major/F Minor Sharp; B Major/G Minor i mprehtë dhe Db Major/A Minor i mprehtë dhe arpezhet e tyre përkatëse në gjendjen themelore dhe të gjitha përmbysjet;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përvetëson aftësi në mënyrë që të mund të kryej shkallët diatonike;</li> <li>- luan dy shkallët kromatike të E Major, B Major, Ab Major, Db Major;</li> <li>- respekton artikulacionet:legatto dhe staccatod dhe me alternim ndërmjet këtyre dyve;</li> <li>- kryen shkallë me figurat ritmike në nota gjysmë, nota çerek, nota të tetëshe dhe nota të gjashtëmbëdhjetë me shpejtësi minimale të notave të barabartë me 78/120;</li> <li>- përvetëson aftësi që lejojnë kryerjen e të njëjtave shkallë me ritme që i përkasin masave të përbëra 6/8, 9/8 dhe 12/8;</li> <li>- përvetëson një artikulim të qartë dhe të pastër – staccato me elegancë gjatë shkallëve, studimeve dhe pjesëve;</li> <li>- përvetëson aftësi për zhvillimin e kujtesës nëpërmjet interpretimit të fragmenteve të shkurtra muzikore.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesë , Romanca, Sonata,</li> <li>- JS Bach -Air and Bourrée;</li> <li>- James Hartley - Sonatina (2nd movement); Paul</li> <li>- Holmes -Slow;</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh epokat dhe stilet e autorëve që do të luajë;</li> <li>- luan me tingull të lidhur dhe me pak rubato;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gilles Jaffe -Centone Tuba Concertante; David</li> <li>- Uber -Summer Night; Clare Grundman -Tuba</li> <li>- Rapsody; Benedetto Marcello - Sonata in F; G.</li> <li>- Puccini -Nessun Dorma</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- performon bukur me të gjitha elementet tekniko-profesionale;</li> <li>- transmeton emocione;</li> <li>- ndjen individualitetin e tij në lojë.</li> </ul>
---	---

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

- Ky program synon të zhvillojë aftësitë muzikore dhe teknike të nxënësve nëpërmjet një qasjeje të strukturuar dhe të progresive në mësimin e muzikës, duke përfshirë përvetësimin e shkallëve muzikore, ushtrimeve teknike, dhe interpretimit të veprave nga kompozitorë të ndryshëm. Programi përqendrohet tek zhvillimi i aftësive teknike në instrument, përmirësimi i artikulimit, ritmit, dhe dinamikave, si dhe njohja dhe interpretimi i stileve të ndryshme muzikore.

### Klasa 6

- Objektivat e Mësimit: Nxënësit do të mësojnë shkallët maxhore dhe minore, të zhvillojnë një qëndrim të mirë të duarve, dhe të realizonin ushtrime teknike. Përqendrimi do të jetë në realizimin teknik të shkallëve, zotërimin e regjistrave të ndryshëm, dhe zhvillimin e barazisë së zërit.
- *Materialet dhe Burimet*: JB Arban, Roger Bobo, Walter Hilgers, etj., do të përdoren për ushtrime teknike dhe frymëmarrje.
- Vlerësimi: Kontrolle teknike do të përfshijnë performimin e shkallëve dhe etydeve, si dhe interpretimin e pjesëve të caktuara.

### Klasa 7

- Objektivat e Mësimit: Përqendrimi zgjerohet në teknikën e legato dhe staccato, frymëmarrjen e kontrolluar, dhe zotërimin e regjistrave të ulët dhe të mesëm. Nxënësit do të zhvillojnë aftësinë për të luajtur shkallë me intervale të ndryshme dhe të kryejnë ushtrime me ritme të ndryshme.

- Materialet dhe Burimet: Vazhdon përdorimi i materialeve nga niveli 6 me shtimin e studimeve specifike në legato nga RH Fink dhe të tjerë.
- Vlerësimi: Shtohen kontrollet teknike dhe performancat e saxho-s me kërkesa për interpretim më të ndërlikuar të pjesëve muzikore.

### **Klasa 8**

